



VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.3(452)

MARS 2026

ÇMIMI: 30 LEKË



Drejtor: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI; website: www.VETERANIOBVL.ORG

LIBRI I RI I HALIT DACIT

SKËNDERBEU NË PROZËN DHE SHTYPIN AMERIKAN

Ish - N/oloneli i ushtrisë shqiptare Halit Daci me banim në Nju Jork, vjen para lexuesit me veprën monumentale më të re, kushtuar Heroit tonë Kombëtar, Skenderbeut



FAQE 12 - 13

GJENERAL PARLLAKU

SI MË SHPËTOI NËNË TARIKA HOXHA PREJ ARRESTIMIT NGA GJERMANËT

Gjenaral Rahman Parllaku
Hero i Popullit & Nderi i Kombit



Tarika Hoxha

FAQE 2

TITULLI

GJENERALMAJOR MANUSHAQE SHEHU "QYTETARE NDERI" E DIBRËS



Nga Halil RAMA

FAQE 9

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë miraton vendimet e Kuvendit të X-të të OBVLP

LEGJITIMOHET STRUKTURA DREJTUESE E OBVLP

REAGIMI

LIRIA KA EMËR

Halil RAMA - Mjeshtër i Madh

Kryesia e Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të LANÇ dhe pasardhësve dënon me ashpërsi aktakuzën absurde, bajate, të pabazuar dhe trilluese të Prokurorisë Speciale të Hagës, kundër ish-drejtuësve të UÇK-së, prof. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Prof. dr. Jakup Krasniqit dhe Profesor Rexhep Selimit. Në një deklaratë për shtyp, kryetarja e OBVLP Tatjana Çarkaxhiu Parllaku, ndër të tjera thekson se "Në Gjykatën Speciale të Dardanisë në Hagë, po i bëhet gjyqi komandantit legjendar të UÇK-së Adem (Shaban) Jasharit dhe gjithë të rënëve e martirëve të luftës. Po i bëhet gjyqi UÇK-së dhe vetë Dardanisë. Gjykata Speciale e Dardanisë në Hagë, duhet ta mbyllë farsën e ngritur mbi akuza e sajesa të pabaza, që për paradoks e shëmti, janë ushqyer edhe prej dëshmish të turpshme të disa shqiptarëve jugosllavë të Dardanisë, të cilët, nuk e kanë për gjë të hedhin baltë mbi gjakun e derdhur në themelet e lirisë së Dardanisë dhe mbi luftën e drejtë e patriotike të UÇK-së. (Vijon në fq.4)

BOTIME

Një "breshër" në mes të Prishtinës për gjyqin e Hagës

Nga Sefer Pasha

FAQE 7



Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me Vendimin Nr.5138/3, datë 23.12.2025 ka miratuar Vendimin Nr. 2, datë 26.07.2024, të Kuvendit Kombëtar të OBVLP që legjitimon zgjedhjen e Znj. TATJANA PARLLAKU ÇARKAXHIU kryetare e kësaj organizate...

Nga Muharrem GJOKA

FAQE 3

Nënkryetar i OBVLP-Mjeshtër i Madh

NDERIMI

KOLONEL TRIFON LLUPO "NDERI DHE KRENARIA" E OBVLP



KRYESIA E OBVLP I UROI DITËLINDJEN N/KRYETARIT TË OBVLP TRIFON LLUPO, I CILI MBAN MBI SUPE TREÇEREK SHEKULLI (75 VJET) KARRIERË USHTARAKE E CIVILE SHEMBULLORE

FAQE 8

NGA KRONIKAT E KOHËS

Pesë kufitarët dëshmorë dhe poema "Dhjetë sy" e Dritëro Agollit

Nga Sakip CAMI

FAQE 5

HISTORIA

TRE DËSHMORË NGA OXHAKU "PRODA" KRENARI PËR SHQIPËRINË

Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

FAQE 6

LIBRI

HEBRENJTË NË SHQIPËRI, ANI WILMS SJELL HISTORINË E RRALLË

SHPENDI TOPOLLAJ

FAQE 14 - 15

KONFERENCA

RISITË QË SJELL KONFERENCA KOMBËTARE E SHOQATËS SË KARDIOLOGJISË SHQIPTARE

Dr. Leonidha Peppo

Kardiolog në Spitalin "Salus" **FAQE 11**

35 VJETORI

SHOQATA "DURRËSI AUTOKTON", PASURI E QYTETARISË DURRSAKE

Nga Kadri Tarelli

FAQE 10

RRËFIMI

Nga libri “Mirënjohje familjeve vlonjate që më mbajtën si birin e tyre SI MË SHPËTOI NËNË TARIKA HOXHA PREJ ARRESTIMIT NGA GJERMANËT



Gjenaral Rahman Parllaku – Hero i Popullit & Nderi i Kombit

Kur fillova ti hedh në letër këto shënime, shumë herë kam pyetur veten se cilët janë heronjtë e vërtetë të asaj lufte, të cilëve është pak t'ju dedikosh nga një libër me vete.

Jemi ne bijtë e asaj lufte, që në moshën e rinisë vumë jetën në shërbim të popullit e atdheut, apo janë prindërit tanë që u bashkuan me ne e që nisën bijtë e bijat e tyre në luftë të bindur në ndërgjegje se mund të mos i shihnin më dhe vumë veten e shtëpitë e tyre në shërbim të luftës, në një kohë kur kudo rrinin varur shpalljet e fashistëve se kushdo që strehon ilegalë, do të pushkatohet dhe do t'i digjet shtëpia. Janë këta prindërit patriotë që meritojnë nderimin më të madh e mirënjohjen e Kombit, e të tillë prindërit e familje Vlora ka pasur shumë. Unë që nuk isha nga Vlora, por që pas lufte nuk them që s'jam nga Vlora e kam ndier më shumë, jo vetëm bujarinë e mikpritjen e vlonjatëve, por edhe guximin e vendosmërinë e tyre për t'u shkrirë familjarisht për lirinë e popullit e të atdheut. Është hera e parë që shkruaj dhe druaj se s'do të mund të jap të plotë portretin e këtyre njerëzve të feve e shtresave të ndryshme, që i kishte bashkuar shpirti liridashës, ndonëse po përpiqem me gjithë shpirt ta bëj këtë.

Në çdo lagje të Vlorës ka pasur baza të tilla, ku unë gjeja familjen time dhe prindërit e mi që i kisha larg, prandaj duke mos ditur nga ta filloj më parë, vendosa ta nis nga Llonxha (Partizani), nga Nënë Tarika, siç e thërrisim ne të gjithë. Tarika Hoxha, nëna ime e dytë, ishte një grua e thjeshtë që po rriste fëmijë të vegjël jetimë, pa baba, në një kohë kur dy djemtë e rritur Feçorri e Hysni, luftëtarë të njësiteve guerrile vdiqën në kampet naziste.

Ishte 9 tetori i vitit 1943 kur nazistët të udhëhequr nga ballistë e tradhëtarë e rrethuan qytetin dhe bënë kontrollin e arrestime në masë. Atë natë Hysni, Feçorri e guerrilës të tjerë të drejtuar nga ish zëvendësi im, Miço Emini, kishin punuar deri në mesnatë për të pastruar mbi 200 pushkë, 12 mitralozë të lehtë, 7 mitralozë të rëndë, 4 mortaja e municionet e tyre dhe ua jepnin guerrilasve për t'i shpërndarë në disa pika e për t'i nisur për në repartet partizane.

Nënë Tarika tregon se kur u kthyen djemtë në shtëpi, kishte kaluar mesi i natës. Kishin ngrënë dhe kishin rënë për të fjetur, kur në gjumin e parë, pa trokitur, kishte shpërthyer dera e kasolles dhe ata ishin zgjuar nga fenerët e gjermanëve që ndriçonin fytyrat e të 5 djemve që po flinin krahu njeri – tjetrit mbi rrogazin e shtruar përdhe (edhe unë kisha kaluar shumë net mbi atë rrogaz). Hyrja e tyre ishte e befasishme pasi kallauzi (informatori) që

u printe nazistëve ishte i lagjes dhe e njëjthe mirë kasollen. Djemtë e përgjumur nuk patën mundësi t'i rrëmbejnë armët dhe një tentativë e Miços, dështoi, pasi atë e mbërthyen në moment dy nazistë. Pas kontrollit u arrestuan Miçua dhe tre djemtë e nënë Tarikës, në mes tyre dhe Gjyshi 13- vjeçar, i cili ato ditë ishte plagosur aksidentalisht në këmbë me automatikun e Çobanit. Nëna i ndoqi djemtë deri në qendrën e grumbullimit të të arrestuarve. Ajo mbante në shpinë Gjyshin dhe ju lutej atyre ta lironi, se i rrëzuar nga biçikleta kishte thyer këmbën dhe se ishte akoma i vogël. Njëri nga ballistët i tha se do t'ja lironin Gjyshin, dhe po të merrte vesh e t'i njoftonte ku isha fshehur unë do t'ja lironin edhe dy djemtë e tjerë.

Nënë Tarika me Gjyshin në shpinë kthehet në kasolle dhe merr vesh se unë isha aty afër, në shtëpinë e Mulla Sulos, (babai i Akademik, Shaban Demirajt, që ishte Hoxhë). Ajo erdhi më takoi menjëherë dhe më dha lajmin e arrestimit të Miços, të djemve të saj e të qindra të tjerëve. Edhe sot i kam në vesh fjalët e saj: Gëzohem që ke shpëtuar. Ata pyesin çdo të arrestuar për ty. Mua ma lejua Gjyshin, por më porositën; po more vesh ku është Rrahmani, do të t'i lirojmë edhe dy djemtë e tjerë.

Unë ata i kam djem gjaku, por ty të kam djalë hakikati. Armiqtë me ty e kanë



Feçorri e Hysni Hoxha



Tarika Hoxha

mllëfin (inatin), por dhe ne me ta e kemi inatin. Po qe e shkruar të mi vrasin fëmijët, unë s'jam as e para dhe s'do të jem as e fundit nënë që i vriten fëmijët për Shqipërit. Ruaju e mos u bjer në dorë.

U përqaftuam e u ndamë me lot në sy me këtë nënë heroike. Nënë Tarikën e shumë nëna të tjera nga Vlora shkoja e i takova me t'u kthyer nga luftimet e reparteve tona në Jugosllavi, në maj të 1945, para se të shkoja për të takuar prindërit e mi. I jam ndodhur pranë Nënë Tarikës deri sa vdiq, po kështu edhe fëmijëve të saj, e nënave të tjera. Po me ato nëna që bënë aq shumë për ne, për luftën, mendoj se nuk do të shlyhemi kurrë, gjatë gjithë jetës. Bëmë shumë pak për to, për të mos thënë asgjë!! Arsyet janë të kuptueshme, nuk kishim kopetencën.

Po kthehem te një nënë tjetër, të cilës emrin ja mësova vetëm tani që po shkruaj. Është Nënë Tarika, kështu e thërrisim të gjithë ne si vajzat e saj, Hyri Drenovën, nënën e tri partizaneve trime Ylvjes, Hanes dhe pionieres luftëtare Fairesë. Shtëpia e Nënokës ishte e hapur për të gjithë luftëtarët e lirisë. Në shtëpinë e saj bëheshin takime, mbledhje, ilegalët linin armatimin, pakot me komunikata. Atje u mbajt i arrestuar edhe spiuni Azem Spolata, që denoncoi heronjtë e Topanas, etj.

Ne bëmë mbledhje e Nënokja me një shall a pallto mbi supë na bënte roje pranë gardhit të oborrit të mbuluar me manaferra, dhe kur do të dilnim nga shtëpia, ajo dilte para nesh e kontrollonte rrugën përpara shtëpisë dhe rruçicën që ngitej lagjes përpjetë. Nënokja mund

t'i linte vajzat e saj pa ngrënë, po ne asnjëherë s'harronte të na pyeste a kishim uri dhe shpesh herë na e shtronte bukën pa na pyetur fare. Ylvia, që shquhej për karakterin e saj burrëror i la Lilon e vogël disamujsh ta mbante Nënë Tarika dhe bashkë me të shoqin, bashkëluftëtarin e saj, Skënder Kreshpa dolën partizanë. Të dy, ata mjekkonin e shëronin plagët e partizanëve dhe ju ndodhën pranë atyre edhe në operacionet më të egra të fashistëve.

Ylvjen e arrestuan në prill 1943 dhe e internuan në Porto Romano dhe pastaj në Burrel, nga ku u lirua më 31 korrik, kur u çlirua Burreli.

Me arrestimin e Ylvjes, nënë Hyrijes dhe dy vajzave të tjera iu bë i pamundur qëndrimi në qytet, pasi shtëpia e saj ishte gjithnjë nën mbikqyrjen e agjentëve fashistë. Hëna, vajza tjetër e Nënokës ishte një nga organizatorët e drejtueset e rinisë në qytet, kurse pionierja Faie, si korriere, na bënte shërbime nga më të ndryshmet, na transportonte materjale propagandistike dhe nganjëherë bënte edhe punën e zbuluesit. Them me bindje se të tri vajzat e nënokës e meritonin të ishin vajzat e një luftëtareje dhe patrioteteje të madhe si ajo. Por fatkeqësisht Nënokës në vend që t'i shpërbleheshin me të mira sakrificat e luftës, ju krijuan mjaft fatkeqësi në jetën e saj dhe të vajzave, nga lufta e pamëshirshme e klasave që zhvilloi dik-

• **“Nënë Tarika, siç e thërrisim ne të gjithë. Tarika Hoxha, nëna ime e dytë, ishte një grua e thjeshtë që po rriste fëmijë të vegjël jetimë, pa baba, në një kohë kur dy djemtë e rritur Feçorri e Hysni, luftëtarë të njësiteve guerrile vdiqën në kampet naziste...”**

partizanë trima. Sazani dhe Nusreti ishin partizanë të Brigadës së 5- të Sulmuese dhe megjithëse komanda e brigadës ishte përpjekur ta mbante pranë Nusretin që ishte shumë i ri në moshë, ai nuk kishte pranuar në asnjë mënyrë e kishte shkuar në vijën e parë të luftës, në grupin e sulmit, ku edhe në sulm u vra.

Nënë Havaja e duroi me stoicizëm dhimjen e madhe të vrasjes së Nusret Kanakarit, të cilin e kishte rritur me shumë mundime, siç kishte duruar ajo edhe vdekjen e largët të Halimit. Kjo nënë që vuajti gjithë jetën e që i dha dy breza luftëtarësh çështjes kombëtare e luftërave për liri, meriton nderimin më të madh të Kombit. Do të kthehem përsëri në Llonxhë për të përkujtuar një nënë fisnike, jo nga prejardhja e saj, por nga edukata, sjellja e bujaria. Nënë Shefikati Cenko kishte dy vajza, njëra me të meta fizike, që i kishte rritur me punë të mundimshme. Në kasollen e saj gjeje gjithmonë një ambjent të pastër e të këndshëm. Dhe pozicioni i saj ishte shumë i përshtatshëm për veprimtarinë tonë, pasi na siguronte hyrje e dalje në qytet pa rënë në sy të armikut. Shumë ilegalë kanë qëndruar me ditë të tëra në atë shtëpi ku kemi bërë mbledhje e takime të partisë, rinisë, të Këshillit Nacionalçlirimtar, të lagjes, etj. Aty mbajtëm të arrestuar dy agjentë të kriminelit Isa Toska, të dërguar prej tij për të gjurmuar e vuarë një të kërkuarin e tij. Na u kërkua të mërnim informata prej tyre dhe më pas i dërguam në repartet partizane. Gjatë gjithë aktivitetit që ne zhvilloim në shtëpinë e tyre, nënë Shefikati dhe e bija e saj Nebija, jo vetëm na shërbenin me përkushtim, po edhe ruanin e vigjëltonin se mos na ndodhte gjë. Por këtë veprimtari ato e paguan shtrenjtë me arrestimin dhe internimin e të shoqit të Nebijes, të vetmit mashkull të shtëpisë.

Këto nëna e motra që treguan gatishmëri e vetmohim në luftën për liri sot nderohen me mirënjohje nga të gjithë.

*) Patrioti – Arif Hasko, ishte një nga luftëtarët e parë e përgjegjës i guerrileve të qytetit. Ai më pas u bë përgjegjës i luftës në krahinën e Treblovës, me krijimin e batalioneve partizane, komisar batalioni, në maj të 1944 komisar i Brigadës së I- rë Sulmuese dhe pas çlirimit Komisar Divizionit. Pas çlirimit të vendit ai mbaroi studimet e larta ushtarake në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Sovjetike dhe shërbeu me detyra të larta në njësitë e ushtrisë dhe në Ministrinë e Mbrojtjes, deri Shef i Shtabit të Përgjithshëm dhe Zv.Ministër i Mbrojtjes, ku mori gradën Gjeneral-Lejtnant. Me Arifin më ka lidhur jeta dhe shoqëria ushtarake. Ne luftuam bashkë në Vlorë, mbaruam bashkë studimet akademike, punuam për afër 30 vjet në drejtimin e ushtrisë dhe vuajtëm bashkë në burgun e Burrelit

LEGJITIMIMI

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë miraton vendimet e Kuvendit të X-të të OBVL

LEGJITIMOHET STRUKTURA DREJTUESE E OBVL



Nga Muharrem GJOKA
Nënkryetar i OBVL-Mjeshtër i Madh

Në më se tri dekada aktivitet intensiv, OBVL u dëshmuua para shqiptarëve si Organizata që vlerëson lart kontributin e shquar të popullit shqiptar në Luftën e Dytë Botërore, që dënon krimet e komunizmit, që mbështeti fort Luftën e drejtë të UÇK dhe në tërësi çështjen mbarëkombëtare shqiptare.

E krijuar para 32 vitesh me nismën e një grupi prej 64 personalitetesh, gjeneralësh dhe luftëtarësh, figura politike të respektuara, por fatkeqsisht të dënuar nga regjimi komunist, Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës së Popullit Shqiptar (OBVL) do të bëhej promotore e mbrojtjes së vlerave tona kombëtare. Në këtë grup bënë pjesë figura politike të respektuara që kishin qenë drejtues të repartëve partizane, mnistra e zv/ministra, siç ishin: Dr. Ymer Dishnica, gjeneral Rrahman Parllaku, gjeneral Nexhip Vinçani; Sadik Bektashi (gjeneral lejtnant - Hero i Popullit), gjeneral Muhamet Prodan, Skënder Malindi, Edip Ohri, Kiço Ngjela, Manol Konomi, Fadil Paçrami, Maqo Çomo, dhe Ernest Jakova; luftëtarët e shquara, drejtues në luftë e aktiviste të OBVL: Selfixhe Broja(Ciu), Zenepe Golemi (Ashiku), Golemi (Ashiku), Liri Belishova, Vera Ngjela (Pojani) e disa të tjera, por fatkeqsisht të dënuara nga regjimi diktatorial i Enver Hoxhës. Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës së Popullit Shqiptar (OBVL) është një organizatë shoqërore atdhetare. Ajo u formua që të vlerësojë realisht historinë e luftës së lavdishme Nacional Çlirimtare, që të shmangë shtrembërimet e periudhës së regjimit totalitar, mohimet dhe politizimet e bëra si rezultat i regjimit diktatorial të E.Hoxhës, por edhe me qëllim të caktuar nga individë që kërkonin lavdi dhe pushtet të pamerituar. Në kurthin e tyre ranë me dëshirë dhe me servilizëm historianë të ndry-

• Me Vendimin Nr.5138/3, datë 23.12.2025, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka miratuar depozitimin në regjistrin e Organizatave Jofitimprurëve të kësaj gjykate të vendimeve nr. 1 dhe nr.2, datë 26.07.2024 të Kuvendit të X-të Kombëtar të Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të LANÇ (OBVL).

Më konkretisht, me Vendimin nr. 1, të këtij Kuvendi, ndryshohet Neni 1 i Statutit të OBVL me këtë përmbajtje: “Organizata mban emrin : Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare e Popullit Shqiptar dhe Pasardhësve dhe logo OBVL - me shkrtim.

Ndërsa me Vendimin Nr. 2, datë 26.07.2024, Znj. TATJANA PARLLAKU ÇARKAXHIU zgjidhet kryetare e OBVL.

shëm që e shtrembëruan historinë e LANÇ.

OBVL, veteranët dhe pasardhësit e tyre, anëtarë të kësaj organizate ndjehen më krenarë se kurrë me historinë e saj të suksesshme 32 vjeçare dhe angazhohen për të ecur në shembullin e themeluesve, që organizata jonë të vazhdojë të funksionojë si mbrojtëse e flaktë e vlerave të lirisë.

Mbrojtja, propagandimi, ruajtja, mbajtja gjallë e vlerave të historisë sonë kombëtare, e veçanërisht atyre të LANÇ-it, dhe transmetimi i tyre te brezat pasardhës është dhe mbetet qëllimi themelor i OBVLsë.

Anëtarët e OBVL, veteran dhe pasardhës ne ndjehen më krenarë se kurrë për faktin që Shqipëria gjatë Luftës së Dytë Botërore u vendos në anën e antifashistëve, fitimtarëve, dhe frontit të madh të lirisë, meritë kjo e partizanëve shqiptarë, këtyre kalorësve të çlirimit dhe të lirisë. Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës (OBVL) në 32 vjet veprimtari ka përmbushur misionin e saj historik, të ruajtjes, mbrojtjes e zhvillimit të vlerave të Luftës, nga më të lavdishmet për liri e pavarësi të shqiptarëve në trojet e tyre etnike në Ballkan, të luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare kundër pushtuesve fashistë italianë e nazistëve gjermanë. OBVL u themelua me përmbysjen e sistemit diktatorial enverian në përputhje me frymën e përpjekjeve për bashkim të shqiptarëve, shprehur në Konferencën e Pezës dhe Marrëveshjen e Mukjes, me program e statut gjithëpërfshirës. Ajo dha një kontribut të çmuar gjatë këtyre tri dekadave të periudhës së tranzicionit të brishtë, ende të papërfunduar në RSH. OBVL përfshiu në radhët e saj ushtarakë e veteranë të OUPLSH, të organizatave demokratike të veteranëve, shtresa veteranësh jashtë tyre dhe kreu veprimtari në lëvizimin e vlerave, të traditës e të legjislacionit, në dobi të veteranëve, të invalidëve e familjeve të dëshmorëve si dhe në hartimin e legjislacionit për këto shtresa. OBVL, në veprimtarinë e saj u distancua nga sistemi totalitar



i partisë-shtet. Ajo shtriu bashkëpunimin e saj me të gjitha shtresat, pa paragjykuar bindjet e tyre; me ata që përkrahën luftën, e mbështetën atë dhe e ndihmuan, e që sot ende nuk përfaqësohen me organizata të veçanta. OBVL ka njohur shtetin ligjor; ka bashkëpunuar me institucionet e pavarura të tij dhe ka ndërmarrë nisma në dobi të veteranëve, invalidëve e familjeve të dëshmorëve. Në veprimtarinë e saj OBVL nderoi kontributin e të përndjekurve politikë, sidomos të atyre të LANÇ e të ushtarakëve të spikatur që udhëhoqën luftën, por që padrejtësisht u pushkatuan, u burgosën, u dëbuan e internuan.

Gazeta “Veterani”, organ i OBVL pasqyro i dhe pasqyron vazhdimisht veprimtarinë e kësaj organizate dhe ka ndihmuar në realizimin e objektivave dhe detyrave të saj.

Përveç 451 numrave të gazetës “Veterani” në këto 32 vjet, të shumta kanë qenë botimet e librave të veteranëve, të cilat jemi përpjekur ti promovojmë si në Shqipëri ashtu edhe

në Kosovë.

OBVL, në bashkëpunim me Organizatën e Veteranëve të LANÇ të Kosovës, ka përgatitur dhe promovuar bujshëm edhe dy dokumentarët: “Rrahman Parllaku – Një legjendë në kufirin e tri kohëve” dhe “Fadil Hoxha - Arkitekti i Kosovës së lirë”, dokumentarë këto që janë shfaqur si për publikun në sallën e Akademisë së Shkencave Tiranë dhe nga Radio Televizioni Publik Shqiptar (RTSH).

Pas legjitimitimit nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, struktura drejtuese e zgjedhur nga Kuvendi i X-të kombëtar vjen e konsoliduar, e bashkuar dhe me energji e vendosmëri për të lëvruar më tej, pasuruar më shumë historinë reale të LANÇ dhe për të dhënë kontributin e saj real për konsolidimin e demokracisë e të shtetit ligjor, për një Shqipëri anëtare e denjë e NATO-s që ecën vendosmërisht drejt anëtarësisimit në Bashkimin Europian.

REAGIMI

OBVLP dënon qëndrimin absurd të Prokurorisë Speciale të Hagës

LIRIA KA EMËR

Halil RAMA

(vijon nga fq. 1)

DREJTËSIA S'MUND TË PËRM-BUSHET DUKE I DËNUAR TË PAFAJSHMIT

Drejtësia për viktimat nuk mund të nderohet duke ndjekur penalisht të pafajshmit, pajtimi nuk mund të ndodhë përmes ndjekjeve penale selektive dhe të bazuara në etni", ka thënë Thaçi në komentet e tij përfundimtare përpara gjykatës para vendimit, i cili pritet brenda tre muajsh.

Thaçi, 57 vjeç, i përshkroi akuzat e prokurorisë se ai dhe të bashkëpunëtorët organizuan një fushatë të dhunshme për të fituar kontrollin politik të Kosovës si "të pavërteta, krejtësisht absurde dhe thellësisht ofenduese". Ndërsa kryeministri shqiptar Edi Rama ka deklaruar se "Prokuroria nuk pati kapacitetin të provojë asgjë të ngjashme sepse nuk ka asgjë të ngjashme në aktivitetin e 4 udhëheqësve të UÇK. Nuk ka asnjë lidhje aktiviteti i

tyre dhe i UÇK mbi terrorin mbi popullsisë civile, spastrimin etnik, varret masive të njerëzve të pafajshëm, shënjestrimin e fëmijëve dhe grave nga snajperët e vendosur aty me këtë qëllim apo me përdhunime e vrasje, mbytyje njerëzish në lumë. Asgjë. Ata katër burra nuk u armatosën për të ndërtuar një politikë shfarosjeje, por u armatosën kundër një politike shfarosëse.

Nuk u armatosën për të imponuar sundimin e tyre në një territor të huaj, por për të hequr qafe sundimin e të huajve në tokën e tyre."

Sipas Z. Ramaj, gjyqi ndaj ish krerëve është një plan që ka nisur nga raporti famëkeq i Dick Martyt për trafik organesh, për të cilin tha se uron që të mos gjejë kurrë prehe aty ku është".

KËRKESA E KRYEMINISTRIT RAMA PËR PRESIDENTIN TRUMP: TË BËJMË DIÇKA PARA SE GJËRA SHUMË TË KËQJA TË NDODHIN SËRISH".

Në fjalën e tij gjatë mbledhjes së Bordit

të Paqes më 19 shkurt 2026, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, iu drejtua Presidentit të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, duke ngritur çështjen e liderëve të Ushtria Çlirimtare e Kosovës që po gjykohen në Hagë, me theks të veçantë të ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi.

"Presidenti i Kosovës ka kaluar 6 vjet në një paraburgim nga një Gjykatë e Posaçme në Hagë sponsorizuar nga

një sërë vende demokratike pranishme këtu që duhet të vijë turp nga ajo drejtësi ndërkombëtare. Vetëm javën e kaluar prokurori kërkoi 45 vjet burgim për të. Vala e poshtërit në tërësinë e një vendi paqedashës dhe në këtë moment ka disa muaj me një rezultat shkatërrimtar të një gjykate që ka dështuar. Për hir të Zotit, zoti president të bëjmë diçka para se gjëra shumë të këqija të ndodhin sërish".



82-VJETORI

Brigada e VII-të Sulmuese, 120 beteja dhe 3200 kilometra marshime

Më urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH, më 17 mars 1944, në Vlush të Skraparit u formua Brigada e VII Sulmuese (Br.VII S). Në rreshtat e brigadës u rreshtuan partizanë me eksperiencë në luftë të batalioneve të qarkut të Beratit, të Grupit të Skraparit, të batalionit të rinisë "Margarita Tutulani" etj. Erdhën gjithashtu dhe mjaft partizanë nga qarku i Gjirokastrës dhe nga qarku i Korçës. Në komandë të brigadës u emëruan: komandant Gjin Marku dhe pas Musa Daci; komisar Kadri Hoxha dhe më vonë oficer karriere, Qazim Kapisyzi. Kuadro dhe luftëtarë ishin dhe Adil Çarçani, zëvendës-komisar, Ramiz Alia përgjegjës i rinisë i brigadës, etj. Situata në të cilën u krijua Br. VII S ishte shumë më e favorshme nga ato në të cilat u krijuan Br. V-VI S.



81 vjetori i krijimit të Brigadës së VII-të na kujton disa nga kuadrot që përmendëm më lart, të cilët përbëjnë bërthamën e kuadrove politikë si Adil Çarçani, Myqerem Fuga, Niazi Demi, Tajar Grepcka, Ramiz Alia, Nexhmedin Ballka etj. Më vonë dolën kuadro drejtuese të kompanive të kësaj Brigade, komunistë që ashtu si e nënvizon Myqerem Fuga, u bënë promotori i celulave të kompanive dhe dhanë një kontribut të madh në forcën goditëse të Brigadës, si Foto Çami, Koli Myzeqari, (dëshmor), Skënder Libohova (dëshmor), Guçe Stropani etj.

Me të marrë urdhërin, Gjin Marku iu vu punës organizuese të kësaj Brigade. Ceremonia u zhvillua më 17 mars 1944 në fshatin Vlushë të Skraparit, në atë fshat, ku dy muaj më parë nazistët gjermanë vranë 114 skraparlinj, duke përfshirë edhe ata të fshatrave Krushovë, Kapinovë e Turbehovë. I njëqindpesëmbëdhjeti, Veseli, rrojt, jetoi, për t'u treguar ditëve të pasçlirimit tmerret e luftës dhe vuajtjet e atij populli liri-dashës.

Në faqet e historisë së Brigadës së VII-të Sulmuese radhiten shumë partizanë e kuadro që ranë në ballë të luftës. Po përmendim disa nga kuadrot drejtuese politikë: Koli Myzeqarin, Skënder Libohova, komandant batalioni, Haxhi Dokon, Fahri Zaimin, Mehdi Vilën, Loni

Odiçanin, Thimi Tanin, Naim Gurin, komisar kompanie.

Brigada luftonte dhe rritej në numër. Gjatë rrugës luftarake u shtua dhe me dy batalione të tjerë.

Në të vërtetë edhe pse brigada la në fushën e betejës 302 dëshmorë, arriti numrin në 2229 partizanë. Ata 142 partizanë që u plagosën, u mjekuan nëpër spitalet partizane dhe u kthyen sërish në luftë, të cilën e vazhduan deri në Vishegrad. Veprimtaria e Brigadës së 7-të Sulmuese nuk mund të përmblidhet në një shkrim përkujtimor, por u përpoqëm të japim detaje nga ato luftime e beteja që nuk kanë të numëruar, por deri tani janë publikuar 120 beteja dhe 3200 kilometra marshime.

Zhvilloi më se 120 beteja e luftime. beteja të përgjakshme si ajo e Qafës së Shkozës në Skrapar në 3 e 4 qershor 1944, për mbrojtjen e punimeve të Kongresit të Përmetit, ku ranë për të mbetur të gjallë komandanti i batalionit të tretë Gani Nivica, partizanët trima Ferit Bregu, Mestan Hamzollari, Izet Dizdari, Adem Emiri, Aliko Gllava, Eqerem Bakalli etj. Veprimet luftarake i vazhdoi në Nahijen e Beratit, në Myzeqe, na Jagodima, Marinëz, Bubullimë e Çiflig të Lushnjës, në Rroskovec, në Patos, në Imshtë, Sqepur etj.

Në shtator 1944 forcat e brigadës zhvilluan luftime të përgjakshme në Berat

ku arritën që më 13 shtator të çlirojnë qytetin e Beratit. Në këtë kohë brigade, me urdhër të Shabit të Përgjithshëm, kaloi lumin Shkumbin drejt Veriut të vendit. Luftime të përgjakshme u zhvilluan në Gëziq, Shpal dhe Rrëshen.


Gjatë gjysmës së dytë të muajit nëntor luftimet vazhduan në Lezhë, Shkodër, Zadrimë, Vaun e Dejës, Bushat dhe së fundmi në çlirimin e Shkodrës më 29 Nëntor 1944.

Mbas çlirimit të Shkodrës brigada e 7-të Sulmuese u inkuadrua në Divizionin e 6-të dhe me urdhër të komandantit të Përgjithshëm, Enver Hoxha, kaloi në luftime përtej kufijve shtetërorë, në Kosovë e qytete të tjera në ish Jugosllavi, duke zhvilluar beteja të përgjakshme në Mal të Zi, Vishegrad, Bosnje, Novi Pazar e kaloi në Suharekë, përkrah vëllezërve tanë kosovarë. Nga radhët e brigadës së 7-të S ranë në fushën e betejës 302 dëshmorë dhe u plagosën 150 partizanë e partizane.

Për këtë histori të lavdishme në kemi folur e do të flasim me zë të lartë për t'iu kundërvënë atij sulmi që kanë ndërmarrë pinjollët e bashkëpunëtorëve të pushtuesit, pseudohistorianët e gjithë lumi që duan ta mohojnë epokën më të lavdishme të historisë sonë, e shkruar me gjakun e mbi 28 mijë heronjve e dëshmorëve dhe sakrificat e 70 mijë luftëtarëve e luftëtarëve.

NGA KRONIKAT E KOHËS

Pesë kufitarët dëshmorë dhe poema “Dhjetë sy” e Dritëro Agollit



Nga Sakip Cami

POSTA KUFITARE E LUMIT TË GASHIT, 14 DHJETOR 1958.

Ndërsa binte shi i përzier me borë, në zyrën e oficerit të rojës bie telefoni i alarmit kufitar. Komandantit Gjokë Jakut i erdhi urdhëri luftarak për të zënë Qafën e Ali Celës ku pritej të kalonin shkelësit e kufirit. Qafa e Ali Çelës është 2260 metra mbi nivelin e detit dhe me terren të vështirë malor. Menjëherë komandanti mbledh efektivin e postës dhe bashkë me katër ushtarë nisen drejt detyrës. Në ballë të borës e suferinës i pari prin komandanti Gjokë Jaku, pas tij ushtarët: Ilmi Alimani nga Dibra, Gani Domi nga Tirana, Isuf Dervishi nga Elbasani dhe Hasan Qylafi nga Tirana.

Nëntoger Gjok Jaku nga Gojani i Pukës pasi kishte mbaruar Shkollën e Policisë në degën e kufirit ishte emëruar komandant i postës kufitare të Lumit të Gashit, një ndër postat më të largëta të Tropojës. Ecin e ecin, veshhtësitë janë të mëdha, detyra duhej kryer me çdo kusht. Atdheu mbi çdo gjë tjetër, kufiri i paprekshëm. Nuk ndalen, marshojnë në lartësitë e bjeshkëve. Me shumë mundime arrijnë në Qafën e Doberdolit. Përballë u shfaqet Qafa e Ali Celës. Kufitarët janë lodhur e dermuar nga bora e rruga e gjatë. Kush e ka provuar e di mirë se dëborë të këput gjunjët, të jep dremitje, pa kuptuar të thith në gjirin e saj. Dritëro Agolli në poemën “Dhjetë sy” kushtuar pesë kufitarëve dëshmorë shkruan: “...Këtu dëborën/ Shtypnin dhjetë këmbë/ Këtu shikonin/ Bjeshkët dhjetë sy/ Këtu lundronin/ Pesë gjokse shkëmbi...” Në ecje e sipër bie kufitari i parë duke mos e përballur më tej rrugën e vështirë mes borës e suferinës. Shokët e marrin mbi supë e vazhdojnë rrugën.

Dy sy u mbyllën përgjithmonë. Tetë sy mprehin vështrimin, tetë këmbë çajnë borën. Dhe ecin, të dytit që mbante shokun mbi supë i errësohen sytë dhe bie. Bien me rradhë njëri pas tjetrit. Bora e trashë i mbuloi të pesë kufitarët. Ata ngrinë, u bënë akull, u bënë shkëmb, u bënë përmendore. U deshën shumë ditë për të gjetur trupat e kufitarëve në borë. Nga Geghyseni 30 djem të rinj morën rrugën për në bjeshkë në



kërkim të trupave të ngrirë e të mbuluar nga dëborë e madhe. Qëndruan në bjeshkë derisa i gjetën. Sjellja e trupave në qytetin e Bajram Currit është pritur nga të gjithë banorët me lot në sy. Të mbledhur pranë shkollës u bë një ceremoni, ku foli komandanti i kufirit i asaj kohe, Ndreko Rino, Hero i Popullit. Nga këtu të vendosur në 5 makina ushtarake, të mbështjellë me flamuj kombëtarë u derguan në rrethet e tyre. Ata u shpallën dësh-

morë të Atdheut. Për ta shkroi shtypi i kohës. Heroizmi i tyre u bë lajtmotiv i kohës.

Artistja e Merituar tropojane Fatime Sokoli thuri një këngë për përjetësimin e 5 kufitarëve dëshmorë të Tropojës. Po citojmë disa vargje të kësaj kënge:

“N’Doberdol ka mbri furtuna / Seç na i mori këto pesë burra / S’ishin burra, por djem të ri / Nga njëzet (vjet) kurrnja përmbi / Nëntogeri njëzet e dy ...”

NGA POEMA “DHJETË SY” E DRITËRO AGOLLIT


Poeti Dritëro Agolli, asokohe gazetar në gazetën “Zëri i Popullit” shkroi poemën “Dhjetë sy”, ku e përshkruan me detaje reale dhe artistike rënien e tyre në krye të detyrës, gëlltitjen e tyre nga dëborë e madhe.

Ja disa fragmente kryesore të poemës:

...Mes mjegullës së dendur
Pas njëri tjetrit
Pesë kufitarë
...Pesë gjokse shkëmbi
Përmes furtunës..

Erë e stuhi
I pari ra nga kosa e furtunës
Përmbi qerpik
u shkrinë flokë bore
Shikoi mes ëndrrës
Nënë pranë Bunës..
Borigat
Edhe tokën prindërore.

Ç’të shihte tjetër?!
S’kishte as të dashur,
As motra,
As vëllezër,
As baba...
I erdhi keq
Që nënën



buzëplasar,
Të thinjur,
Pranë lumit Bunë e la. ...

Në bjeshkë
Rrinin hapur
Dhjetë sy;
Dy sy u mbyllën si agim mbi lumë,
Dy krahe
mbi dëborë ranë ...

I dyti,
Që mbi shpatull

mbante shokun
Filloi të shihte
Yje mes shtrëngatës
Shtrëngoi
Me njëren dorë ballin
Kokën;
U vrenjt
Dhe ra
mes mjegullës së natës...
Dhe ende mbante
Shokun përmbi shpinë. ...

Të tjerët ndoqën rrugën e përpjetë
Dhe fshesa-erë
Fshinte
Shenja ...
Gjurmë...
Dhe katër sy
U mbyllën vrik për jetë
Kur tatëpjetë
ortiqet bënin zhurmë.

...Edhe i katërti u shtri si tre të tjerët
E kush mund të mendonte
Se një ditë
Një ditë në mëngjes të ftohtë
Herët,
Një telegram i hidhur do të vinte :
Dhe babës do t’i thoshte: S’ke më djalë!
Dhe mua do më thoshte: S’ke më

shok!

...Dhe mbeti
Vetëm njëri
Nëpër bjeshkë,
Të tjerët, si ndër përralla
Gur u bënë ...
Dhe mbeti vetëm njëri
Por s’u ndal ...
Te qafë e Ali Çelës erdh;
Shtrëngoi automatikun
Dhe u ul
Si të ishte në llogore,
U mbështet
Plot llahtarë
Era fryu : E mbushi gropa
Kallkan e bëri kufitarin
Dhe mbet si karakoll i tmershëm
Me sy çelë
Eh, qafë e Ali Çelës,
Ali Çelë !
...Te ky obelisk pishe
Mbi përrua
Këtu dëborë e maleve të lartë
E flakur nga tufani i tërbuar
I mbylli dhjetë sy
Të zez, të kaltër:
I mbylli dhjetë sy të dashuruar....

E kush më mirë se Dritëroi ynë i Madh do ta përshkruante heroizmin e 5 heronjve të bardhësisë ?!

HISTORIA

Në nderim të bijëve të Fushëbardhës labe, në respekt të gjakut të derdhur për lirinë e Atdheut

TRE DËSHMORË NGA OXHAKU “PRODA” KRENARI PËR SHQIPËRINË



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

LEGJENDA E GJALLË LABE HALIL SULLO/PRODA, DËSHMOR I QAFËS SË SKËRFICËS/FUSHËBARDHË

Halil Sullo/Proda lindi në Fushëbardhë të rrethit Gjirrokastër në qershor të vitit 1862. Ai ishte në këtë periudhë edhe kryeplak i fshatit dhe që kishte marrë pjesë në të gjitha përballjet luftarake me të huajt si me turkun dhe me grekun. Në moshën 16 vjeçare kur kish parë luftën me sy në Lëkurës, kishte qenë nizamë për shtatë vjet (1880-1887) në Anadoll, ku ishte rritur e burrëruar dhe kish mësuar artin luftarak të kohës. Atje kishte mësuar përdorimin me mjeshtëri të armëve, kamës dhe thikës. Rridhte nga një familje me tradita të pasura luftarake e lridashëse. Të parët e tij kishte luftuar historikisht me pushtuesit. Aktiviteti i tij lidhet me pjesëmarrjen në Kuvendin Cepos më 21.7.1911, Kuvendin e Shtëpëzimit më 10.4.1914 si dhe me veprime mbrojtëse në Fushëbardhë, Fushëvërrin, Skërficë, Hon, etj. Në Cepo më 21.7.1911, Halil Sullo/Proda ishte zgjedhur anëtar i komitetit që u ngrit në këtë kuvend të madh antiosman, me rreth 800 luftëtarë përfaqësues nga Gjirrokastër, Përmeti, Tepelena, Delvina, Kurveleshi, Janina, Çamëria. Më 10.4.1914 Halil Sullo së bashku me disa luftëtarë nga Fushëbardha shkuan në Kuvendin e Shtëpëzimit, ku ishin mbledhur përfaqësitë e Kurveleshit, Kardhiqit, Rrëzomës, ku ishin Çerçiz Topulli, Hasan Xhiku, Sulo Beqiri, Selam Musai, Sali Vranishti, Mersin Gjoça, Bajram Ligu, etj. Nga të huajt ishin kapiteni holandez De Val (De Éaal), lejtanti Juljus Sonne dhe ekipi mjekësor i përbërë nga ushtarake Tido Reddinguis, Van Vliet dhe civili De Groot. Kuvendi mori vendimin të mbrohej çdo pëllëmbë e tokës shqiptare. Halil Sullo/Proda kryeplak dhe komandant i çetës së Fushëbardhës i bëri thirrje luftëtarëve, komandoi luftën një javore të Skërficës për mbrojtur me çdo kusht me çdo sakrificë. Ai luftoi trimërisht në Gurët e Bashe, kroi i Resule, Lisat e Skën-

• *Kushtuar tre dëshmorëve të vatrës patriotike nga oxhaku “Proda”: Halil Huto Sullo/Proda (1862-1914), rënë në moshën 52 vjeçare dhe shpallur dëshmor me vendim nr. 162 datë 30.11.1979; Xhezo Dervish Proda (20.9.1926 - 10.9.1944), rënë në moshën 18 vjeçare dhe shpallur dëshmor me vendim nr. 65 datë 2.10.1971, është njohur me vendim nr.4 datë 27.11.2002; Tajar Shemsi Proda (2.6.1924-22.3.1945) rënë në moshën 21 vjeçare dhe shpallur “Dëshmor” me vendim nr. 127 datë 30.5.1985, të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”, që funksionon në Ministrinë e Mbrojtjes..*

dos, Shpella e Dhespinës, Vrahull, në Qafë të Skërficës etj. Ishte komandant, organizator dhe luftëtar i kudondodhur. Pas një qëndrese heroike të përgjakshme ra dëshmor më 25.6.1914 në Qafë të Skërficës, në hyrje të Shkëmbit të Skamanos në Kamenikë. Andartët kishin një forcë luftarake prej 450 andartë e ushtarë bashkë, ndërsa çeta e Fushëbardhës me në krye Halil Sullon/Proda. Për vrasjen e komandantit të çetës tek Shkëmbi i Skamanos poeti dhe patrioti pjesëmarrës në Betejën e Skërficës, Ramiz Harxhi, ose sikurse thirrej nga luftëtarët në Skërficë “doktori” që lidhte plagët e të plagosurve në Qafë të Skërficës shkruante: “Në luftën e rreptë, q’u bë në Skërficë./Ku, kundër një tufe, luftoi një pakicë./Gryka e Skërficës, një grykë e keqe./Mbrohej prej ca burrash pa armë e fysheqe./Luftonin shqiptarët me qindra barbarë./Me ushtarët grekë veshur si andartë.”/Mitrlozat ngulur, topa anembanë,/Të shkullnin nga vend nja dyzetë luanë./Trimërisht luftuan me rrëmbym sa s’thuhet./Sa q’ajo betejë as mund të përshkruhet./Këtu grekë u grinë, u grinë e u korë./Po dhe trimat tanë dhanë ca dëshmorë...Halil Sullo/Proda është shpallur “Dëshmor i Atdheut”, me vendim nr. 162 datë 30.11.1979 të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit Gjirrokastër. Gruaja e Halil Sullon/Prodës, Kane Sullo/Proda e qau me ligje: “O imzot a derëzi,/Kush do të bëhet si ti,/Të dalë në pleqësi./Për sinor e për kufi./O imzot dhëmbëstërralli,/Si duron e të mban varri,/Ngreu imzot dhe një herë./Ngjish gjerdan e merr dyfeknë...”. Emri i tij ngeli i ndritur në historinë luftarake, në lapidarin e Skërficës, në memorialin “Fushëbardha-2014”, në librat e historisë, në memorien e kombit shqiptar dhe të mbarë shqiptarizms për historinë që shkroi me veprën e tij, për çetën luftarake që drejtoi me zotësi të spikatur luftarake.

XHEZO PRODA DËSHMOR I B. RVI S “HERO I POPULLIT” KRENARI PËR SHQIPËRINË

Xhezo Dervish Proda lindi në djepin e mençurisë dhe trimërisë, në prehërin e traditës luftarake, mes maleve labe një shekull më parë, në

vjeshtën e parë, ditën e hënë më 20 shtator 1926, në oxhakun “Proda” në lagjen e Onjere në Fushëbardhë. Xhezo Proda rridhte nga një familje fushëbardhase me tradita luftarake, patriotike e atdhetare. Nga fisi dhe trungu familjar i Xhezos në vijimësi kishin luftuar me pushtuesit sa herë binte kushtrimi i luftës. Kështu babai i tij Dervish Proda dhe Zilfo Proda ishin pjesëmarrës në Luftën kombëtare të Vlorës më 1920-tën. Ato pak klasë fillore i mori në Fushëbardhë të Gjirrokastër. Çizmjia e rëndë e pushtimit kishte pllakosur si në çdo fshat të Labërisë, edhe në vendlindjen e tij, Fushëbardhën. Mjedisit familjar megjithë hallet e kohës ishte një unitet brezash, unitet familjar dhe të përbashkuar me bashkëfshatarët e bashkëkrahinorët e dy krahinave të Kardhiqit dhe të Rrëzomës nëpër shekuj në luftime për liri, pavarësi dhe çlirim nga pushtuesit osmanë, grekë, italianë, austrohungarezë e deri nazifashistët gjermanë. Në trungun familjar të oxhakut “Proda” janë të njohur në Fushëbardhë Kapo Proda me katër djemtë Ismaili, Dervishi, Fetani dhe Shemshi. Kapua ishte martuar me Hatemen nga fisi Logli i Zhulatit. Ismaili ishte martuar me Hazbije (Bije) Baze nga Peshatani i Tepelenës dhe kishin katër fëmijë dy djem dhe dy vajza: Aliun, Kasëmin, Sheko, Sadife, si dhe Hazbon (me gruan e parë). Dervishi (Xhako i flisnin) ka qenë martuar me Zejnebi (Bijo)/Proda (Veliu) me të cilën lindën katër djem e dy vajza: Xhezo, Afife, Babuden, Siadete, Ulsi dhe Vehipi. Fetani martuar me Aleme Meçe/Proda nga Fushëbardha (motra e Fejzo Meçe ish-kryeplak në FB 1930-1940); lindën dy djem Sherifin dhe Kapo si dhe tri vajza: Gaze, Haxho dhe Beze.

Shemsiu ka qenë martuar me Neko Shalari dhe patën dy djem: Tajarin, Lumanin. Pasi ndërroi jetë Nekua, Shemshiu u martua me Alemen nga Zhulati dhe lindën Xhemalin e Barjamin. Në rrethin më të afërt familjar të dëshmorit Xhezo Proda ishin tre vëllezërit dhe dy motrat. Dervish Proda dhe Zejnebi (Bijo)/Proda i mëkuan bijtë e bijat me dashurinë për Atdheun, me etjen për liri. Pasi ra në fushën e nderit biri i tyre gjithë pasardhësit mbajtën lartë idealet pa-

triotike dhe atdhetare sikurse ishin dhe mbetën atdhetarë: Afifja që u martua me Shefqet Golemin lindën Iblo, Shpëtim, Drita, Sabihe. Shefqet Golemi kishte qenë partizan që në vitin 1942. Ndërsa Babudeni me Bele Cama/Proda lindën Republika, Dervish, Telha, Zhuljeta, Afron e Kristina; Siadeteja dhe Dervish Biro lindën Zurhanë dhe Eli; Ulsiu me Xhemmo Hoxha/Proda nga Vergoi lindën Agimin, Fatmirin dhe Margaritën; Veipi me Theodorën lindën Erjonin dhe Rudinën. Faktet vijjnë nga kujtimet e nënës së dëshmorit Xhezo Proda, Zejnebisë: “Kur lindi Veipi në shtëpinë tonë ishte gjëmë e madhe sepse 3 muaj e gjysmë më përpara ishte vrarë Xhezua në Labinot... vetëm gjyshja Hatua kujdesej për Veipin e vogël...Xhakua e donte për mendje të kokës...i urtë, punëtor, i zgjuar, i dashur...i pjekur para kohe, i vendosur si Xhakua (i ati)...lufta mori djem, ajkën e djalërisë dhe për Fushëbardhën...”. Prodajt ishin dhe mbetën një oxhak i madh me rrënjë lisi me vlerë trashëgimie atdhetarie, që i bëjnë nder fshatit, trevës labe. Edhe komandanti i çetës së Fushëbardhës në Skërficë Halil Sullo ishte një “vatër-zjarri” të një oxhaku, pasi fisi Sullo e Proda janë oxhak i pandarë. Nga të gjithë fëmijët e Dervish Prodës, Xhezua “u martua” me lirinë dhe ngeli në përjetësi meteor ndriçues e frymëzim për brezat, ngeli i trupëzuar me lirinë në Labinot të Elbasanit më 10 shtator 1944 bashkë me dhjetë partizanë të tjerë dëshmorë lirie, Xhezo Proda, Balil Peçi, Luto Çani, Sulo Baka, Halil Halilaj, Neki Hasani, Bajram Lalaj, Riza Çani, Tefik Selaj, Jonuz Balilaj, Merdan Kalemaj. Familja e Xhezos ishte e respektuar në fshat e krahinë, por vlerat ja shtoi më shumë gjaku i derdhur për lirinë e Shqipërisë, duke konsoliduar vijimësinë patriotike të fisit Proda. Xhezua është shpallur dëshmor me vendim nr. 65 datë 2.10.1971, si dhe statusi është njohur me vendim nr.4 datë 27.11.2002 të Komisionit Qendror të statusit “Dëshmor i Atdheut”. Vepra e tij dhe gjithë dëshmorëve është farë e shqiptarizms që meriton të “mbillet” si farë lirie për atdhetari, patriotizëm e frymëzim brezash.

(Vijon në faqen 7)

BOTIMET

Për librin “Heshtja që flet” kushtuar Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Një “breshër” në mes të Prishtinës për gjyqin e Hagës

Nga Sefer Pasha

Dikur në rininë time e kam marë dorazi librin “Vdekja më vjen prej syve të tillë” të Rexhep Qoses, që nga piramida 18 midis fshatrave Valbonë dhe Vuthaj të Malit të Zi. Librin e përcolla për në Tiranë dhe ai u shumfisha në Shtëpinë Botuese “Naim Frashëri”. Sot kjo ndodhi duket si legjendë. E kujtova këtë detaj se libri i autorit Ahmet Shala “Heshtja që flet” më gjeti në Bibliotekën Kombëtare në çastet kur në Prishtinë sa kishte filluar promovimi i këtij libri me personazh heronjtë Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi. Botimi i këtij libri u përhap në të gjithë planetin. Përse? Të katër personazhët e këtij libri janë atdhetar. Ajshtanji thotë: - “Mos syno të jesh njeri

• **Mick Kicklighter thotë: “Ky libër është shumë i rëndësishëm. Duhet ta marim seriozisht. Duhet jo vetëm ta lexojmë, por dhe të veprojmë për të korrigjuar këtë situatë dhe për të parandaluar që diçka e tillë të ndodh sërish. Lutjet e mija janë me ata burra në burg dhe familjet e tyre. Lutem që ky makth të përfudojë sa më shpejt”**

i suksesit, por syno të jesh njeri i vlerave”. Një poet i dëgjuar gjithashtu ka thënë: - “Unë jam ti. Unë jam tek ti dhe ti tek unë”. Në këtë vështrim të gjithë shqiptarët janë në Hagë. Pikërisht për këtë arsye libri i Ahmet Shalës është me identitet paçka se triumfalizmi i atyre që janë në Hagë është tragjik e në buzë të greminës.

Libri i ri i Ahmet Shalës sot kaloi dorë më dorë tek lexuesit e Bibliotekës Kombëtare. Me të mbërritur nga Prishtina në Tiranë të gjithë duan që të

blejnë. Kjo vepër që nuk ka asnjë lloj kremi me lidhshmëri emocjonale i ka shfronëzuar heronjtë e vet të cilët po dënohen për të vdekur për së gjalli. Në kapitujt e librit vijëzimet tejet modeste të autorit janë shkruar me një stil të thukët. Jepet biografia e fisme proverbiale e komandantëve të luftës të UÇK –së, që edhe në gjyqin e Hagës janë elegant. Këso dore në faqet e veprës së Shalës jepen qartazi superbuqetat e jetës së zgalemave si Thaçi, Krasniqi, Veseli dhe Selimi.

Jeta e këtyre heronjve siç doli dhe në gjyqin që po zhvillohet ajo është një higjenë e ashpër për prokurorët e Hagës. Autori i librit është polemist. Ai mëton dhe sjell qysh në krye format metaforike me ndriçim të brishtë në Kosovën e lirë. Në fletët e librit biografik ceken dhe dëshmitarët spiun të serbit, ziliqar, urith, llum, vrasës e të paguar. Heronjtë në Hagë nuk janë me makth në ajër. Përkundrazi ata me energji pozitive nuk shkërmoqen. Principet i kanë të qelibarta.

TRE DËSHMORË NGA OXHAKU “PRODA” KRENARI PËR SHQIPËRINË

(Vijon nga faqja 6)

TAJAR PRODA DËSHMORI QË U GJAKUS NË PRIZREN, POR U SHUA NË GEGHYSEN TË TROPOJËS

Tajar Proda ishte lindur 102 vite më parë, më 2 qershor 1924 në Fushëbardhë të Gjirokastrës. Ai ngeli jetim në moshën 6 vjeçare dhe të afërmit e morën në Tiranë, tek teza Tahire Shalari, që ishte martuar me ushtarakun madhor të mbretërisë shqiptare Kamber Proda. Në shtëpinë e tyre tek Pazarit i ri Tajari kreu arsimimin fillor dhe më tej shkollën amerikane “Harry Fultz”.

Edhe pse shkoi në Tiranë Fushëbardha ngeli në ëndërat e tij feminare. Pas përfundimit të shkollës kreu një kurs për radio-telegrafist dhe shërbeu për pak kohë edhe në qytetin e Kukësit.

Falë njohjes së bashkëfshatarëve dhe tezes së tij Tahiresë, por edhe ndikimit të Kamber Prodës, gjeti punë dhe u angazhua në shërbimet e komunikimit dhe postave në Kukës. Fakt është se Fushëbardha e lindi, Tirana e mësoi, Kukësi e burroi dhe e mësoi në rrugën e vështirë të jetës, pasi në Kukësin e vjetër zuri miq e shokë, ndjehej si zot shtëpie. Shtëpia e jetimit është aty ku ka miq e shokë të mirë. Tajari u rrit në familjen e ushtarakut madhor Kamber Proda, por ai e lidhi jetën e tij të

re me idealet antifashiste kudo ku shërbente. Vullëtarisht u bashkua me partizanët e BrVS, brigadë që bashkë me forcat e tjera të UNÇSH, me urdhër të Komandantit suprem të LANÇ-it kapërceu kufijtë për çlirimin e trojeve shqiptare të Kosovës, për çlirimin e “Shqipërisë Londineze”. Tajar Proda shërbeu në detyrën e radiotelegrafistit, kreu detyra luftarake në zonën e Matit, Dibrës, Kukësit, Prizrenit edhe në përbërje të BrVS. Fakt është se në këtë periudhë ishte një djalë i rritur, shtathedhur, me arsyetim e gjykim plotësisht të formuar, pasi referenca për kohën ishte antifashizmi, mendimet e pjekura që synonin vetëm lirinë, edhe pse ai e dinte mirë atë që kishte shekuj që e kishte thënë filozofi i ndritur Plutarku: “Mendja nuk është një enë që duhet mbushur, por është një zjarr që duhet ndezur”. Gjatë luftimeve të përgjakshme në jugperëndim të Kosovës, ranë shumë dëshmorë dhe u plagosën mjaftë luftëtarë të tjerë.

Djali jetim nga Fushëbardha plagoset rëndë në Prizren mjekohet në betejë dhe vazhdon luftën. Urdhërohet nga komanda e Brigadës që me të plagosurit e tjerë të çohet në Gjakovë dhe prej andej në rajonin e Tropojës, në spitalin partizan të Geghysenit të Bujanit të Tropojës. Atje në Alpe në Geghysen nuk mundi të shijonte ditët e lirisë, atje dha frymën e fundit me fjalët në buzë “..jam nga Fus-

hëbardha..”, por ngeli përjetësisht “dëshmor”, dëshmor i Shqipërisë.

Eshtat e tij preheshin për 70 vite pranë ish-spitalit partizan në Geghysen – Selimaj të Tropojës, në Alpet e Shqipërisë, aty ku historia i përkund në një djep legjendat, kreshnikët dhe dëshmorët. Shoqata “Fushëbardha” e drejtuar nga Trifon Golemi më 8.9.2016, shkoi në Selimaj, Geghysen, Tropojë për marrjen e eshtave të partizanit 20 vjeçar që luftoi për lirinë e Atdheut. Ceremoniali i përcjelljes së eshtave u zhvillua në Tropojë dhe më tej në varrezat e dëshmorëve të Gjirokastrës ku ishte edhe amaneti i përmbushur për dëshmorin fushëbardhas Tajar Shemshi Proda. Ai prehet me dëshmorët e luftës dhe të idealit për një Shqipëri të lirë dhe të pavarur, aty ku prehen dëshmorët e brigadave parti-

zane që gjakun e derdhën për lirinë e kombit shqiptar. Tajar Shemsi Proda është dëshmor nr.341 i BrVS, dhe që ra më 22.3.1945.

Skeda e dëshmorit në Ministri të Mbrojtjes thotë: Tajar/Tetar Shemsi Proda ish-luftëtar partizan i BrVS është shpallur “Dëshmor i Atdheut”, me Vendim Nr. 127 datë 30.5.1985, të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”. Janë tre dëshmorë nga një vatrë, një oxhak gjurinonë i ndezur për Atdhedashurinë pasi në Fushëbardhë të Labërisë janë bashkëudhëtarë historia, atdhetaria, kombi, përjetësia.

Halil Sullo/Proda, Xhezo Dervish Proda dhe Tajar Shemshi Proda mbeten pjesë e trupëzuar e krenarisë labe dhe shqiptare, e përjetësisë në piedestalin e vlerave të lirtisë së kombit.



NDERIMI

KOLONEL TRIFON LLUPO

“NDERI DHE KRENARIA” E OBVLPI

Në ditëlindjen e 75-të Kryesia e OBVLPI, ndërsa e ka uruar për zemërisht e ka vlerësuar nënkryetarin Trifon Llupo me titullin “NDERI DHE KRENARIA E ORGANIZATËS”, me motivacionin “Për kontributin e tij si Nënkyetar i Organizatës, duke evidentuar dhe promovuar LANÇ e personalitetet e saj dhe për konsolidimin e strukturave të OBVLPI, sipas përvojës së tij dhjetra vjeçare si kuadër shembullor i Ushtrisë Shqiptare.

Trifon Filip (Lipi) Llupo ka lindur në Lushnje më 08. 02. 1951, kur Shqipëria ishte duke rënkuar akoma nga plagët e Luftës Dytë Botërore dhe po luftonte për “shërimin” e tyre.

Edhe babai i Trifonit, që thirrej Lipi nga shokë e tij, tani i ishte kthyer familjes prej 6 antarësh, pas përfundimit të Luftës Nacionalçlirimtare.

Rreshtimi i Babait në radhët e Formacioneve partizane, ka një veçori të veçantë sepse ai edhe duke qenë djali i vetëm iu përgjigj Thirrjes së Frontit të Këshillit Nacionalçlirimtar dhe u rreshtua në radhët e Grupit Partizan të Myzeqesë që në krijim, në Shtator të vitit 1943 dhe pastaj në radhët e Brigatës 16 sulmuese, që u krijua në Theresel të Skraparit, ku u rreshtua Grupi Partizan i Myzeqesë

Pra, Trifoni rrjedh nga një familje patriotike e liridashëse dhe këto veti e virtyte i ka bërë të vetat dhe i promovon më së miri edhe tani.

Megjithatë një familje e madhe, prindërit e Trifonit me sakrificat e mëdha të kohës arritën që t'i arsimojnë të 7 fëmijët me arsim të lartë, duke i bërë kuadro të denjë për të shërbyer Atdheut, ashtu siç i doli për zot Atdheut, babai i tij edhe djali vetëm, dje në luftë.

Trifoni pasi kreu arsimin 7 vjeçar në fashtin e tij të lindjes erdhi dhe kreu arsimin e mesëm në Shkollën Ushtarake Skënderbej” në Tiranë, dhe më vonë kreu edhe Arsimin e lart ushtarak duke i shërbyer Atdheut në radhët e Forcave të Armatosura, në funksione të larta, deri Shef i Sektorit Ushtarak në Ministrinë e Burimeve Minerare dhe Energjitikës, duke dalë ne rezerve me gradën Kolonel dhe më pas, u fut në organikën e Ministrisë Brendshme, përsëri me funksione të larta deri Shef i Sektorit e zv. drejtor i Policisë Zjarrfikëse dhe Shpëtimit, me gradën Komisar në Lirim.

Trifoni ka një kontribut modest edhe gjatë Luftës për çlirimin e Kosovës, pasi ai u përfshi në mbështetje të kësaj Luftë nga Komisariati i Lartë i Refugjatëve i Organizatës së Kombeve të Bashkuara,(UNHCR).

Në fillim UHCR hapi Zyrën Qendrore të saj pranë qeverisë shqiptare, të kryesuar nga Fatos Nano, në Ministrinë e Pushtetit Lokal, ndërsa zyra e parë lokale u hap në Bajram Curri, Kukës, pasi kishin filluar bombardimet e NATO- s, në Kosovë dhe filluan të vijnë refugjatët e parë në Bajram Curri.

Ai në fillim u emërua në funksionin Kryetar i Zyrës në Bajram Curri

dhe kur u rrit fluksi e u shpërndanë të ardhurit (Refugjatët) nga Kosova në disa qarqe të vendit, u transferua Kryetar i Zyrës Refugjatëve i Qarkut të Durrësit deri në përfundim të misionit të UNHCR-s.

Zyra e fundit që u mbyll në Mars të vitit 1991, ishte Zyra e Durrësit, ku u organizua Procesi i Votimit për zgjedhjet e para në Kosovë pas luftës.

Këto zgjedhje u organizuan nën kujdestarinë e nën patronazhin e UNHCR-ës dhe Trifoni u ngarkua si Kryetar i Qendrës Votimit në Durrës, për Zgjedhjet e para në Kosovë, ku do votonin të gjithë shtetasit e Kosovës, që ndodheshin në Shqipëri, që nuk ishin kthyer në shtëpitë e tyre.

Krahas këtyre detyrave e funksioneve të larta në administratën shtetërore e publike, Trifoni është aktivizuar edhe në jetën shoqërore, duke u dalluar edhe këtu, si një aktivist i shquar për mbrojtjen e traditave patriotike e atdhetare. Ashtu si babai i tij, partiazani Filip (Lipi) Llupo, i cili edhe duke qenë djali i vetëm i Familjes Andon Llupo, që iu përgjigj Thirrjes së Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar, edhe Trifoni iu përgjigj dëshirës dhe vlerësimit që kishte për të, ish Komandanti i Divizionit të 5-të, që e ndoqi bishën naziste deri jashtë kufijve të Shqipërisë, deri në Vishegrad të Jugosllavisë, “Heroi i Popullit” dhe “Nderi i Kombit” gjeneral Rrahman Parllaku, drejtuesi për 20 vjet i Organizatës Bashkuar të Veteranëve të Luftës dhe Pasardhësve(OBVLPI). Trifoni u bë antar i OBVLPI dhe që nga ajo ditë që i premtoi kryetarit të OBVLPI, gjeneral Parllakut, ai ka punuar e punon me përkushtim për realizimin e misionit për të cilin është krijuar OBVLPI, për të mbajtur lart traditat e popullit shqiptar dhe trashëgimin e propagandimin e traditave të Luftërave të popullit Shqiptar për Liri e Pavarësi.

Trifoni që nga kuvendi i VIII-të është zgjedhur antar i Kryesisë së Kuvendit Kombëtar e deri në funksionin e lart të N/kryetarit të Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës dhe Pasardhësve (OBVLPI) në Kuvendin e X-të, mbajtur në datën 26. 07. 2024 dhe vazhdon ta kryejë me përkushtim këtë detyrë.



• **KRYESIA E OBVLPI UROI DITËLINDJEN N/KRYETARIT TË OBVLPI TRIFON LLUPO, I CILI MBAN MBI SUPE TREÇERËK SHEKULLI (75 VJET) KARRIERË USHTARAKE E CIVILE SHEMBULLORE**



TITULLI



Këshilli Bashkiak vlerëson gruan e parë shqiptare që mban gradën madhore në FA të RSH

GJENERALMAJOR MANUSHAQE SHEHU “QYTETARE NDERI” E DIBRËS

Halil RAMA – Mjeshtër i Madh

Generalmajor Manushaqe Shehu, e vetmja grua shqiptare me këtë gradë madhore, gjatë karrierës së saj të shkëlqyer mbi 40 - vjeçare në Forcat e Armatosura, ka marrë disa tituj e mirënjohje nga institucione kryesore shqiptare e ndërkombëtare. Gjithsesi, vlerësimi që ju bë në qytetin e vendlindjes së saj Peshkopi, më 23 Janar 2026, duke i dhënë titullin “Qytetare Nderi” e Dibrës nga këshilli i Bashkisë Dibër, është më i veçanti dhe më impresionuesi për të dhe familjen e saj. Ky vlerësim ju bë gjatë një takimi mbresëlënës të organizuar nga Bashkia Dibër, me pjesëmarrjen e dhjetra personaliteteve, përfaqësues të elitës intelektuale dibrane.

Kryebashkiaku i Dibrës Z. Rahim Spahiu, që përveçse përkushtimit dhe vizionit bashkëkohor me të cilin ka realizuar dhe synon të realizojë një program ambicioz zhvillimor, konkretizuar në dhjetra projekte madhore infrastrukture në të gjitha njësitë Administrative të kësaj bashkie, deri në zonat më të largëta malore, si Lura e Kalaja e Dodës, ka meritën edhe për evidentimin dhe vlerësimin e personaliteteve dibrane të gjitha fushave.

Ndaj dhe në këtë takim të organizuar nga Bashkia e stafi i tij ai do të shprehë optimist për vlerësimin e gjeneralmajor Manushaqe Shehut, që si bijë dibrane, nderon jo vetëm Dibrën, por gjithë Shqipërinë. Ndër të tjera në këtë takim ceremonial ai tha se Bashkia dhe Këshilli Bashkiak Dibër nderojnë me titullin e lartë “Qytetare Nderi”, Gjeneralmajore Manushaqe Shehu, bijë e Dibrës dhe gruaja e parë që mban këtë gradë në historinë e Forcave të Armatosura Shqiptare. Ky vlerësim, sipas kryebashkiakut Spahiu është shprehje e mirënjohjes për kontributin e saj të çmuar në shërbim të Atdheut, për profesionalizmin dhe integritetin e treguar ndër vite, si dhe për shembullin frymëzues që përcjell për brezat e rinj, veçanërisht për vajzat dhe gratë shqiptare. Pasi i shprehu urime dhe mirënjohje të thellë Gjeneralmajore Manushaqe Shehut, kryebashkiaku Spahiu tha se “Nga Dibra kanë dalë dhe do të vazhdojnë të dalin figura që i shërbejnë kombit me dinjitet, përgjegjësi dhe përkushtim të lartë, dhe ne i kemi vlerësuar

• Me vendimin nr. 82, datë 03.11.2025, Këshilli Bashkiak Dibër ka vlerësuar kontributin e saj të jashtëzakonshëm në mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare, promovimin e vlerave kombëtare, të figurës së gruas shqiptare në strukturat më të larta të shtetit dhe për shembullin frymëzues që ajo përçon për brezat e rinj

dhe do t'i vlerësojmë vijimësi”.

DITË E VEÇANTË PËR DIBRËN DHE DIBRANËT

Një ditë të veçantë për Dibrën dhe dibranët e ka konsideruar dekorimin e gjeneralmajor Manushaqe Shehu edhe Drejtori i Performancës dhe Ideve të Zhvillimit i Bashkisë Dibër, Dali Horeshka. Në fjalën e rastit ai tha se Bashkia Dibër nderon një nga bijat e saj më të shquara, duke i akorduar znj. Manushaqe Shehu titullin “Qytetare Nderi”, si shprehje e mirënjohjes së thellë për një jetë të tërë në shërbim të atdheut. Ai bëri të ditur për pjesëmarrësit se, me vendimin nr. 82, datë 03.11.2025, Këshilli Bashkiak Dibër ka vlerësuar kontributin e saj të jashtëzakonshëm në mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare, promovimin e vlerave kombëtare, të figurës së gruas shqiptare në strukturat më të larta të shtetit dhe për shembullin frymëzues që ajo përçon për brezat e rinj.

“E lindur më 5 nëntor 1965 në Sohodoll Dibër, znj. Manushaqe Shehu vjen nga një familje dibrane me tradita të shëndosha e të shkëlqyera. Qysh në rini, ajo zgjodhi rrugën e vështirë të uniformës, duke e shndërruar pasionin në mision dhe misionin në një karrierë të ndritur prej mbi 37 vite në shërbim të Shqipërisë.

Gjatë këtij rrugëtimi, ajo ka mbajtur detyra me përgjegjësi të lartë në Forcat e Armatosura dhe institucionet shtetërore: nga Shefe e Logjistikës në Brigadën 3900 në Peshkopi, deri në funksione drejtuese në Ministrinë e Mbrojtjes; nga Këshilltare Ushtarake e Presidentit të Republikës, te Drejtoreshë e Bashkëpunimit Civil-Ushtarak; Komandante e Akademisë së Nënoficerëve, Komandante e Komandës së Doktrinës dhe Stërviçjes; Zëvendës shefe e Shtabit të Përgjithshëm dhe, për një periudhë, Shefe e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Arritja e gradës Gjeneral Ma-

jor, si gruaja e parë në historinë e Forcave të Armatosura të Shqipërisë që ka mbajtur këtë gradë, është një moment historik, që dëshmon se përkushtimi, profesionalizmi dhe vlerat nuk njohin pengesa dhe se dibranëve që u dhimbset Kombi dhe Dibra, kudo ku kanë punuar kanë lënë gjurmë të pashlyeshme vlerash.

Për Dibrën, znj. Manushaqe Shehu nuk është vetëm një gjenerale e sukseseshme. Ajo është një shembull i fuqishëm për vajzat dhe djemtë tanë, një dëshmi se nga kjo trevë mund të ngrihen figura që i shërbejnë vendit me dinjitet, urtësi dhe guxim”, tha Drejtori Horeshka.

Në emër të Bashkisë Dibër dhe të gjithë qytetarëve të saj, ai e falenderoi gjeneralmajore Shehun për gjithçka ka bërë për Shqipërinë dhe për nderin që i ka dhënë Dibrës. Urime për titullin “Qytetare Nderi e Dibrës” dhe faleminderime i shprehu gjenerales edhe Prefekti i Qarkut Dibër Nexhbedin Shehu. Si ish - zyrtar i lartë në Ministrinë e Mbrojtjes ai vlerësoi karrierën ushtarake dhe akademike të saj edhe si doktore e Shkencave, që gjeneralja i ka fituar me meritë.

Në ceremoninë e organizuar më 23 janar 2026 në mjediset komode të Hotel “Veri” Peshkopi, gjeneralmajor Manushaqe Shehu është përshëndetur dhe uruar për zëmërisht edhe nga Kryetari i Këshillit Bashkiak të Dibrës, Z. Sokol Sava, si dhe nga Drejtori i Shkollës 9-vjeçare Sohodoll Fatbardh Cena.

“TË JESH NDERUAR NGA VENDI YT NUK ËSHTË VETËM KRENARI, ËSHTË DETYRIM MORAL”

Pasi ka përshëndetur kryebashkiakun Rahim Spahiu, përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe vendore, personalitete të kulturës e historisë, të pranishëm në këtë takim vlerash, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, e emocionuar, thellë është shprehur se të jesh nderuar nga vendi yt nuk është vetëm

krenari — është detyrim moral. “Sot e ndiej këtë peshë me dinjitet, me mirënjohje dhe me emocion të thellë. Dibra ka qenë gjithmonë tokë e fjalës dhe e besës. Është thënë me të drejtë se “Në Dibër, nderi është si buka – nuk jepet shkel e shko.” Këtu njerëzit nuk maten me fjalë të mëdha, por me punë të heshtura. Dhe pikërisht kjo frymë e ka ndërtuar karakterin tim. Jam rritur në një familje ku prindërit e mi të ndershëm dhe punëtorë më mësuhan se nderi nuk trashëgohet – fitohet. Se shërbimi për vendin është guri i themelit të dinjitetit. Se fjala është kontratë. Se për të ecur përpara duhet të mbash shpinën drejt, jo kokën ulur. Rrugëtimi im profesional, deri në gradën e gjeneral-majorit, si gruaja e parë në historinë e vendit që mban atë uniformë, nuk ka qenë i lehtë. Ka qenë një rrugë sakrifice, vendosmërie dhe besimi. Por Dibra më mësoi diçka thelbësore: se pengesat nuk të ndalin, përkundrazi të farkëtojnë. Sepse njeriu formohet në vështirësi, jo në komoditet. Sot, ky titull është më shumë se një çmim. Është një lidhje e ripërtërirë mes meje dhe vendit tim të origjinës. Është një nder për prindërit e mi, të cilët nuk jetojnë më, por vepra e tyre rron në mua dhe në atë që unë kam qenë e jam. Është një amanet për familjen time, për djalin tim që sot është vetë baba, dhe për mbesën time Lori, vetëm dy muajshe, që rritet me dashurinë e një familjeje ku nderi dhe puna janë themele. Dua t'i drejtohem sot edhe brezit të ri të Dibrës: Mos kërkonti rrugë të shkurtra. Mos kërkonti lehtësira. Mos kërkonti duartrokitje boshe. Rrugën e lavdisë e ndërton vetëm ai që nuk ka frikë nga vështirësia, nuk ka frikë nga sakrifica dhe mbi të gjitha – nuk ka frikë nga përgjegjësia. Se Dibra nuk rrit njerëz të dorëzimit, rrit njerëz të qëndrësës. Me nder të madh e pranoj këtë titull. Iu uroj që Dibra të mbajë gjithmonë

(Vijon në faqen 11)

35 VJETORI

SHOQATA “DURRËSI AUTOKTON”, pasuri e qytetarisë durrsake

Nga Kadri Tarelli

Pak ditë më parë, më 10. 02. 2026, në sallën veprimtarive të QKF Durrës, u kremtua 35-vjetori i Shoqatës “Durrësi Autokton”, një ndër shoqatat më të vjetra në Shqipëri, e rikrijuar në periudhën e hyrjes së vendit në demokraci. Megjithëse rrënjët i ka rreth 90 vite më parë, më 1935, në kohën e “Monarkisë”. Shoqata ka dhe feston dy ditëlindje. Koha dhe trashëgimia është vlerë që duhet kujtuar dhe nderuar.

E gjithë veprimtaria ishte menduar bukur. Në hyrje nisi me një fotoekspozitë ku pasqyronte aktivitetin e shoqatës në këto 35 vite veprimtari.

Në fjalën e tij përshëndetëse, kreu i shoqatës z. Abdulla Deliallisi përmendi nismëtarët e krijimit, rrugëtimin ndër vite, bashkëpunimet me shoqata simotra dhe organizata të ndryshme, si dhe shprehu mirënjohje për të gjithë anëtarët dhe bizneset durrsake, që kanë mbështetur aktivitetet e shoqatës ndër vite.

Mbrëmja vijoi me himnin e qytetit “Të falem, i bukuri Durrës”, interpretuar nga këngëtari durrsak Dhimitër Stefa, si dhe me një paraqitje virtuozë nga violinisti Enver Qerimi, i cili si durrsak i hershëm nuk mungon në festat dhe veprimtaritë, sa herë që organizon shoqata.

Pjesë e programit ishte edhe shfaqja e dokumentarit, “Diplomati Antitabu”, kushtuar ambasadorit Shaban Murati, (Nderi i qytetit të Durrësit). Dokumentar i realizuar nga Fondacioni “Hasan Tahsini. Çamëria”, me regji dhe operator nga Ylli Pepo dhe Xhemal Reçi.

Këtu po shtoj vetëm pak fjalë: - Nëse dokumentari do të kishte përfshirë edhe Durrësin, me siguri do të vendosej edhe takimi me diplomatin e shquar Shaban Murati, organizuar para një viti në mjediset e Pallatit të kulturës “A. Moisiu”, ku u përrua libri i tij “Antitabu”. Megjithatë pak rëndësi ka, sepse janë disa shkrime që i bënë jehonë kësaj ngjarje, duke u futur në fondin e tij të përjetësisë. Shaban Murati ka vlera të veçanta, si diplomat dhe mendimtar i urtë i mendimit politik, tërësisht atdhetar shqiptar. Dikush duhet të mendojë më gjatë për figurat që nderojnë qytetin dhe qytetarinë durrsake.

Kaq pak fjalë mjaftojnë vetëm si njoftim i shkurtër. Por nuk përmbushin pritshmërinë, sepse janë shumë ngjarje, të cijat janë përballuar nga drejtuesit dhe anëtarët e kësaj shoqate me emër, që po i mbijeton kohës, aq më tepër kur bëhet fjalë për një përvjetor të tillë: 90-vjetor dhe 35-vjetor.

Unë jam anëtar i hershëm i kësaj shoqate, kështu kam ndjekur dhe përjetuar të gjithë jetën dhe veprimtaritë e saj. Ndaj dhe herë pas here, kam bërë disa shkrime që kanë lënë . Kështu, në morinë e ngjarjeve pikante, po ndalem të kujtoj vetëm te disa prej tyre:

Së pari: Ka sjellë në jetën e qytetit dy festa, “Festa e detit” e cila organizohet në fillim të muajit qershor, ashtu edhe “Festa e Ullirit”, që festohet në muaji nëntor të çdo viti. Nuk është gjë e pakët të organizosh veprimtari të tilla, që shoqërohen edhe me shëtitje në det, apo me mbjelljen e një ulliri, po ashtu edhe me koncert festiv, me këngëtarë dhe instrumentistë të ndryshëm, shpesh të ardhur nga qytete të ndryshëm të vendit, si Tirana, Shkodra, Vlora, etj. Sikur vetëm për këto ngjarje, do të mjaftonte mirënjohja jonë si qytetarë të Durrësit.

Ndërkohë festave i shtohet edhe një vlerë tjetër: Nderohen dy-tre apo katër personalitete të qytetarisë durrsake. Të gjithë të përzgjedhur si më të suksesshëm në drejtim të institucioneve të ndryshëm, arsim, shkencë, art, kulturë, sport dhe së fundi edhe në biznes. Nuk kam statistikë, por besoj se numri i tyre është goxha i ndjeshëm, aq sa mund të përmbledhet në një enciklopedi, që po e quaj “Enciklopedi

• *Abdyl Frashëri: “Sa jemi shqipëtarë,/ jemi gjithë një farë,/ kemi gjithë një besë,/ s’kemi kurrë të ndarë...”*



e qytetarisë durrsake”, (Autorët mund t’i vendosin titull tjetër), duke ua lënë brezave për ta plotësuar ndër vite.


Dikush mund të thotë pa e vrarë mendjen, se të tilla veprimtari kanë për detyrë dhe i organizojnë të gjitha shoqatat si motra në mbarë vendin, pavarësisht cilësisë. Po shoqata “Durrësi”, ka meritën se është përballur edhe me ngjarje të mëdha që kanë tronditur kombin, siç ishte pritja e vëllezërve tanë shqiptarë të Dardanisë, në vitet e nxehta të luftës, 1998-1999. Mijëra shqiptarë të shpërngulur dhunshëm nga trojet e tyre shekullore, të detyruar nga ushtria pushtuese serbe, u pritën vëllazërisht nga popullit Durrësit, pavarësisht varfërisë dhe vështirësive të kohës.

Kështu, me që jemi në prag të, 17 Shkurtit, 2008, festa e “Mëvetësisë së Dardanisë”, me pak fjalë po përmend vetëm një veprimtari atdhetare, që nuk duhet harruar, pavarësisht viteve që po ikin ka shpejt:

- Në përpjekje disa ditore, është i paimagjinueshëm bashkëpunimi mes disa shoqatave që vepronin në Durrës, që “Pajtuari” dhe bënë bashkë politikën dhe politikanët e pushtetit lokal të Durrësit. Besoj se është e para herë që partitë politike ulën kokat para shoqatave. Zëri i kombit që lëngon, i zgjoi të mbledhin mendjen, duke hequr dorë nga sherri i pavend dhe pa kuvend.

U organizuan disa takime: Fondacioni “Sulejman Vokshi”, drejtuar nga Qazim Kreka, shoqata “Durrësi” me kryetar Halil Myderizi, shoqata atdhetare “Çamëria”, me kryetar Avdyll Suljejmari dhe shoqata atdhetare-politike “Kosova”, me kryetar Myftar Gjonbalaj, vendosën dhe organizuan në qendër të Durrësit dy mitingje, me thirrjen, “Një komb një qëndrim”. Nuk vonoi edhe mbështetja nga drejtuesit e pushtetit lokal, nga Prefekti Matin Cukalla dhe nga kryetari i Bashkisë Arqile Gorea.

Mitingu i par u realizua para Bashkisë, në fund të majit 1998, dhe i dyti, në shesh para Pallatit të Kulturës “A. Moisiu”, në shtator 1998. Mitingje ku



ushtoi zëri atdhetar, që dënonte agresionin serb, dhe shprehte mbështetje pa kufi të luftës së UÇK dhe ndihmës së forcave të NATO-s dhe SHBA.

Dardania u çlirua në qershor 1999. Gardhi që ndante shqiptarët, i vendosur për afro një shekull më parë, më në fund u prish. Shqiptarët u lidhën mes njëri-tjetrit. Dhe, pas pak vitesh, 17, shkurt, 2008, Dardania shpalli “Mëvetësinë”. Ndërkohë, sot shoqata “Durrësi” mban krenarinë.

Tingëllojnë bukur, ndaj mbeten në kujtesë fjalët e thëna në fund të fjalimit, nga kryetari Avdulla Deliallisi: “Nderim për të shkuarën, besim në të tashmen, shpresë për të ardhmen.....!”

Urime për 35-vite veprimtari të shoqatës “Durrësi Autokton”, në shërbim dhe pasurim të jetës qytetare të Durrësit tonë, 3000-vjeçar!

KONFERENCA

RISITË QË SJELL KONFERENCA KOMBËTARE E SHOQATËS SË KARDIOLOGJISË SHQIPTARE



Dr. Leonidha Peppo
Kardiolog në Spitalin "Salus"

Shoqata Shqiptare e Kardiologjisë gjatë vitit të kaluar ka qenë mjaftë efektive, konkretizuar kjo edhe me ristë që solli në Konferencën Kombëtare të dhjetorit 2025.

Kjo edhe për faktin se në të morën pjesë në mënyrë aktive me referate shkencore e diskutime edhe profesorë e mjekë të njohur nga Shoqata e Kardiologjisë së Kosovës. Bashkëpunimi efektiv ka sjellë zhdukjen e vijës imagjinare që ndan Shqipërinë etnike.

Të angazhuar me mendimin e tyre shkencor në këtë konferencë ishin edhe mjekë të njohur shqiptarë nga Maqedonia e Veriut e Mali i Zi, si dhe nga Italia e Greqia.

Kjo ishte Konferenca Kombëtare më e rëndësishme ku kardiologë të njohur paraqitën jo vetëm tema shkencore të mirëpërgatitura, por edhe postera të përgatitura me mjeshtri profesionale, ku reflektoheshin eksperiencat dhe dijet e tyre nga literatura botërore, të njohura e të vlerësuara për nivelin e lartë shkencor. Madje të njohur për vendet e tyre me mjekësi të përparuar.

Konferenca spikati për tematikat, përvojat, rastet klinike dhe diskutimet e vyera të pjesëmarrësve. Fushat qenë të ndryshme: nga kardiologjia, kardiokirurgjia, raset klinike etj.

Seancat u drejtuan nga profesorë të njohur me eksperiencë të gjatë drejtuese, si Anesti Kondili, Mihal Tase, Artan Goda, Mimoza Lezha, Ali Rafetllari, si dhe Gani Bajraktari nga Kosova. Spikatën gjithashtu Prof. Alban Dibra - shef i Klinikës së Kardiologjisë së QSUT por edhe të rinj në zhvillim e rritje profesionale, si Altin Veshi.

Si moderator të seancave ato e bënë shumë tërheqëse dhe efektive konferencën.

Pati të ftuar edhe profesorë të njohur të huaj, me temat e ligjëruesve prej tyre në të quajturin "Simpodium satelit" nga Kompania e njohur "Bajer". Kështu, Prof. Karsten Tschöpe u ndoq me vëmendje e interes të veçantë me referimin e temës "Cardiopathi mieloide" në Transthyretin, i cili tregoi pamje ku nëpërmjet një maske të vendosur në fytyrë shihnim si në eter transformimin që merr zemra kur preket nga kjo sëmundje.

Profesori nga Letonia Ustay Latorcshik referoi për problemin e madh të shoqërisë botërore, siç është lufta kundër yndyrërave të larta në gjak dhe

për mënyrat si luftohen ato për parandalimin e sëmundjeve të vazave të gjakut, sëmundje këto me vdekshmëri të lartë deri 51 % të të gjitha sëmundjeve që njihen deri sot.

U fol gjithashtu për një shpikje të re, siç është ilaçi "inkliserani", shtesë mjekimi, sidomos tek ata që kanë yndyrëra të larta në gjak dhe vdekshmëri të shtuar.

Këto janë injeksione të lehta që bëhen në krah dy herë në vit. Këtë ilaç kundra yndyrnave në gjak e ka mundësuar kompania farmakologjike "NOVARTIS" që operon në vendin tonë. Reklamimin e saj tek unë e ka bërë dr. Alba, por edhe i gjithë grupi i kompanisë e reklamon në gjithë vendin. Nga ky grup që punon për njohjen dhe përhapjen e këtij ilaçi janë edhe Liljana, Orgesa, Marinela etj.

Gjatë zhvillimit të Konferencës interes ngjalli tema "Diagnoza e valvulopative dhe roli i ECHO kardiakë, e mbajtur nga Prof.asc. dr. Albano Doko, mjeshtrë e vërtetë në këtë profesion. Por përgjegjësinë ndaj tyre e mban kardiokirurgjia, ndaj i takoi prof. Ali Rafetllarit ta paraqesë me aftësi këtë temë. Problematika që kanë gratë shtazëna për qark lindjes u trajtua me profesionalizëm nga Prof. Artan Goda. Ato duan edhe ilaçet e duhura për të cilat bëri paraqitje serioze prof. Mimoza Lezha. Po në të njëjtën linjë u paraqit profesionalisht edhe dr. Aurel Demiraj për sëmundjet që shfaqen tek gratë shtazëna.

Në seancën e dytë të drejtuar nga profesorët Alban Dibra, Mimoza Lezha e Ali Refatllari, referoi profesori nga Kosova Gani Bajraktari me përvojë 11-vjeçare të infarktimit miokardit në Kosovë.

Për një teknikë të hollësishme në

riparimin e anuerizmës referoi dr. Ali Veshaj.

Rreth sëmundjeve të aortës referoi edhe Prof. Selman Dumani. Për riparimin e tyre foli prof. Ermal Likaj.

Interesante dhe e veçantë qe tema për historikun e zhvillimit të kardiologjisë në vendin tonë, mbajtur nga prof. Anesti Kondili që u rrit në këtë klinikë. Gjatë seancës së tretë folën dr. Armand Gjana për revaskulorizim me teknika të ndryshme, por që gjithsesi para revaskulorizimit të artereve koronare bëhet përgatitje me barna. Këtë e sqaroi në mënyrë profesionale dr. Mirand Gina.

Temat e revaskulorizimit të artereve koronare janë të shumta, prandaj duhet kujdes në aplikimin e taktikave. Këtë e bëri të qartë për auditorin dr. Artan Kristo.

Pjesë e rëndësishme e Konferencës ishte paraqitja e posterave që reflektonin përvojën profesionale të mjekëve. Nga këto postetra që kanë edhe çmim monetar fitoi ajo që bën përparim në hierarki e dr. Danjela Teferiçi.

Sipas programit u mbajt Asambleja e Përgjithshme e Shoqatës, për të cilën emrat u propozuan nga udhëheqja, ndërkohë që gjithsecili mund të ndrronte apo të shtonte emra tjerë. Kjo nuk konsiderohet procedurë e drejtë, sepse mund të aplikohet zgjedhja e lirë nga të pranishmit.

Si çdo vit, u ndoq tradita e krijuar me mbrëmjen gala në restorant "Xibraka", me këngë e valle, ku padyshim vëllezërit korçare e bënë më të larmishme dhe e ndezën atmosferën, duke krijuar atmosferë miqësore për të pranishmit.

GJENERALMAJOR MANUSHAQE SHEHU "QYTETARE NDERI" E DIBRËS

(Vijon nga faqja 9)

atë që ka mbajtur ndër shekuj: dinjitetin, mençurinë dhe zemrën. Zoti e bekoftë Dibrën dhe njerëzit e saj", tha gjeneral-major Manushaqe Shehu në fjalën e saj të përsjendëtjes pasi ka marrë titullin e lartë "Qytetare Nderi" e Dibrës.

PAK RADHË PËR PROFILIN E GJENERALMAJOR MANUSHAQE SHEHUT

Veç të tjerash, në profilin e gjeneralmajor Manushaqe Shehut, doktore e shkencave, dhe juriste spikasin vlerat njerëzore. Personaliteti dhe karakteri i saj në asnjë rast nuk devijoi, por u shpalos me dinjitet për më shumë se tri dekada në funksion të zhvillimit dhe modernizimit të Forcave tona të Armatosura. Ishte nga të parët që i fali shpirtin dhe zemrën ëndrës së dëshiruar në vite. Në këtë përditshmëri, ajo mbetet një nga figurat më interesante si përfaqësuese e elitës intelektuale shqiptare. Si njohëse në mënyrë perfekte e dy gjuhëve të huaja (anglisht dhe italisht), dr. Manushaqe Shehu ka përfunduar kursin e CIMIC në Qendrën P&P, Ankara, Tur-

qi (mars-prill 2013), Kursin Gender Perspective in Peasekeeping Operations në Zagreb, Kroaci (qershor 2014); studimet për CIMIC&CIMI Oberamengau, Gjermani (shtator - tetor 2015); Kursin "Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore" në Qendrën P&P, Ankara, Turqi (maj 2016); Kursin e Lidershipit Strategjik, Budva, Mal i Zi (shtator 2016); Kursin e Sigurisë në "Qendra Marshall", Garmish, Gjermani (korrik- shtator 2017) si dhe kursin "Bilding Integrity" në Mbretërinë e Bashkuar (tetor 2017). Në muajin gusht 2018, në mbrojtje të temës "Lidershipi dhe ndikimi i tij në menaxhimin e mjedisit të sigurisë - Rasti i Ballkanit e më gjerë", fiton gradën shkencore "Doktor". Ajo ka botuar një sërë artikujsh shkencorë dhe joshkencorë brenda e jashtë vendit, në revista ushtarake, në shtypin ushtarak e civil. Ajo ka botuar dhe promovuar librin e saj "Lidershipi në mjedisin e sigurisë", duke e renditur veten në radhën e studiuesve seriozë të Forcave të Armatosura dhe të Sigurisë dhe aktualisht si lektore shembullore në një nga universitetet jopublike më prestigjiozë të Tiranës.

Po ashtu ka marrë pjesë në disa aktivitete ushtarake ndërkombëtare në vendet anëtare të NATO-s dhe ato partnere të saj.

Dhe jo vetëm kaq, si intelektuale bashkëkohore, demokracinë e konsideronte sfidë ndaj sistemit që u shemb; sfidë në dinjitet, në vlerë, në përpjekje, në arritje. Thelbi i mendimit dhe veprimit të saj ishte vetëm konkurrenca në vlera. Ajo besoi dhe dëshmoi se njeriun në jetë e mban vetëm dija. Një miqësi me dijen nuk ka moshë, por mbetet e përjetshme. E qetë, e pjekur, shumë e kulturuar, nuk pajtohej me asnjë devijim nga parimet e virtytshme dhe njerëzore, por mbante qëndrim. Shpërthyes dhe autoritare në ndëshkimin e saj individual, sepse përherë qëndronte në vendin e nderit, sinjeritetit dhe dinjitetit. Kuptohej, ajo ishte dhe është individ dhe jo institucion, por idetë dhe praktika e saj mund t'i shërbenin dhe i shërbejnë shumë një institucioni, një misioni. Këto cilësi i manifestoi dukshëm si drejtuese në disa nivele të Ushtrisë Shqiptare, deri në majën e piramidës së saj, si zëvendës-hefe e SHP të FA të RSH-së.

LIBRI I RI

Ish - N/koloneli i ushtrisë shqiptare Halit Daci me banim në Nju Jork, vjen para lexuesit me veprën monumentale më të re, kushtuar Heroit tonë Kombëtar, Skenderbeut

Skënderbeu në prozën dhe shtypin amerikan

• *Reverend James M. Ludlow dhe John H. Crabb, me penat e tyre të fuqishme e shpallën, e përhapën dhe e ruajtën në prozë legjendën e Skënderbeut në Amerikë...*

Halil RAMA
Sakip CAMI

Studiuesi Halit Daci, ish Nënkoloneli i ushtrisë shqiptare, tani me banim në Nju Jork të ShBA, pas disa kërkimeve e studimeve për Heroin tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, botime në gjuhën angleze dhe amerikane, sjell për lexuesit librin voluminoz me mbi 600 faqe me titull: “Skënderbeu në Prozën dhe Shtypin Amerikan”.

Ndërsa libri i N/Kol. Dacit është shkruar për një audience) anglishtfolëse, në vijim po japim për lexuesin shqiptar poi u referohemi parathënies, shënimeve editoriale, hyrjes dhe permbledhjes në faqen e pasme të librit.

Libri përmbledh dy romane të panjohura, si për lexuesit e apasionuar pas shkrimeve për Skënderbeun, ashtu edhe për kritikët letrar, të shkruara nga autorët James M. Ludlow dhe John H. Crabb.

Romani i autorit Ludlow është aq i njohur për lexuesit e huaj dhe ato shqiptar, saqë një botim tjetër, në dukje, është pothuasje i panevojshëm. Ai është botuar si serial i përditshëm në vitin 1905 në 15 shtete Amerikane dhe 26 gazeta Amerikane.

Botimi i N/Kol Dacit është krejt i ndryshëm nga botimet e mëparshme dhe ato aktuale që gjenden në shitje në formë libri dhe digjitale. Ai bën të ditur se romani i njohur i autorit Ludlow u përgatit për botim në formë seriali të përditshëm nga Shoqata e Shtypit Amerikan në vitin 1903.

Ndryshe nga botimet në formë libri, që përmban 56 kapituj, seriali gazetaresk përmban 38 kapituj dhe është i pasuruar me illsutime të piktururara nga piktorë të panjohur më parë nga lexuesit aktual për më shumë se një shekull.

Romani tjetër i botuar nga Dorrance Publishing në vitin 1952, është i plotësisht i panjohur dhe nuk gjendet lehtë në shitje.


Studiuesi Halit Daci na i jep të plotë këto dy romane të hershme për Skënderbeun nga autorët amerikanë.

Libri i tij i sapobotuar, pavarësisht se është botim privat (jo nga shtëpi botuese por që gjendet në Amazon) ndjek rregullat standarte të industrisë amerikane të botimeve, atë të Chicago Manual of Style.

Botimi sjell për here të parë, pas më se një shekulli, më shumë se 150 ilustrime, piktura, imazhe të marra nga arkivat, gazetatat e kohës dhe koleksionet private, duke filluar nga viti 1885 deri në vitin 1970, deri tani të panjohura për publikun.

Përmbajtja është ndarë në tre pjesë kryesore dhe ndjek strikt e stilikisht formën e pasqyrës, paralelizmit, për pjesët dhe autorët.

Pjesa e parë jep detaje mjaft të çmuara dhe deri tani të panjohura në lidhje me angazhimin e James M. Ludlow me figurën e Skënderbeut, duke filluar nga viti 1885. Më tej në pjesën e parë jepet një pasqyrë e burimeve arkivore të botimit në formë seriali, kryesisht në vitin 1905, formë e cila e rriti ndjeshëm numrin e lexueseve të për-



CHAPTER I
FROM the center of the old town of Hupasi, in Asia Minor—old even at the time of our story, about the middle of the fifteenth century—
the guard withdrew. The general turned quickly upon him as soon as they were alone.
“If I mistake not, man, though your tongue be tied, your eye spoke to me by the gate.”

ditshëm amerikan dhe ju dha mundësi të njohin me hollësi figurën legjendare të Skënderbut.

Në pjesën e dytë jepet transkriptimi i plotë i serialit të nxjerrë nga gazeta të ndryshme amerikane nga shkurti i vitit 1905 deri në tetor 1911.

Në pjesën e tretë N/Kol Daci prezanton burimet hulumtuese arkivore në lidhje me romanin e panjohur In the Crescent’s Dark Shadoë (Nën Hijen e errët të Gjysëm Hënës). Në këtë pjesë, autori gjithashtu sjell të dhëna deri tani të panjohura me anë të të cilave rindërton biografinë John H. Crabb. Ai paraqet për lexuesin një analizë kritike të romanit të Crabb-it, dhe e sjell atë më të plotë (nga ai i skaduar copyright ose i parinovuar).

Libri gjendet në Amazon ose mund të porositet



JAMES M. LUDLOW, D. D.
AUTHOR OF
The Captain of the Janizaries



JOHN H. CRABB

direkt nga autori, duke paguar vetem koston e shtypshkrimit, pa fitim.

PREZANTIMI I LEGJENDËS SË SKËNDERBEUT NË NJË PUBLIK TË GJERË AMERIKAN

“Skanderbeg në Prozën dhe Shtypin Amerikan” riprezanton dy tregime fantastike për her-

• *Përmes narrativave të tyre përkatëse, Ludlow dhe Crabb zbulojnë se si heroit shqiptar i shekullit të pesëmbëdhjetë u rikthye dhe u rrimagjinua në forma që gëzuan rezonancë përtej kufijve kombëtarë dhe kohorë....*

oin legjendar shqiptar, Gjergj Kastriotin — i njohur gjithashtu si Skanderbeg ose Iskender Beu. Autori Halit Daci ka meritën se i sjell ato për lexuesin pas një distance kohore prej rreth gjysmë shekulli. Rëndësia e këtij botimi konsiston në faktin se, këto tregime kapin momente të ndryshme në transmetimin transatlantik të legjendës së Skanderbeut.

“Ndërsa njëri prej këtyre novelave, ai i James M. Ludlow, ka pasur një prani të qëndrueshme, edhe pse në evolucion, për lexuesin nëpërmjet botimeve të ndryshme që nga viti 1886 deri në ditët e sotme nëpërmjet pranisë digjitale, tjetri, ai i John H. Crabb është pothuasje i panjohur për lexuesin dhe kritikët letrar. Megjithatë, këto tekste të rikthyer mbeten thuajse të panjohura për lexuesit dhe studiuesit bashkëkohor”, shkruan autori në parathënie të librit. Sipas tij, romani i njohur i James M. Ludlow, The Captain of the Janizaries, ka qenë mjaft i sukseshëm si në format librash ashtu edhe dixhital, duke e bërë një botim të ri të vetë tekstit në dukje të panevojshme. Ky volum, megjithatë, rikthen një manifestim të shquar të punës së Ludlow: serializimin e ilustruar të saj në gazetë. Përgatitur për botim serial në gazetatat e përditshme amerikane në 1903 dhe botuar në 1905, ky version — i dallueshëm nga botimet e librit të lidhur — ishte i pari që e prezantoi legjendën e Skanderbeut në një publik të gjerë amerikan.

Në kontrast, vepra e dytë, In the Crescent’s Dark Shadoë e John H. Crabb, botuar në 1952, është zhdukur pothuajse nga kujtesa letrare amerikane. Vetëm një numër i vogël kopjesh mbi-jetojnë në koleksionet e bibliotekave dhe koleksione private, dhe romani nuk ka prani të njohur dixhitale. Mungesa e tij në diskursin akademik është e dukshme, veçanërisht duke pasur parasysh angazhimin e vazhdueshëm me narrativën legjendare të Iskender Beut.

“Pavarësisht nëse romani ishte një ushtrim i hershëm në ardur scribendi-në e një autori (historiani) të ri ose thjesht i mungonte mbështetja promovuese e një botuesi të vendosur, ai rrëshqiti në heshtje nga qarkullimi publik”, shprehet autori H. Daci.

(Vijon në faqen 13)

LIBRI I RI

Ish - N/koloneli i ushtrisë shqiptare Halit Daci me banim në Nju Jork, vjen para lexuesit me veprën monumentale më të re, kushtuar Heroit tonë Kombëtar, Skenderbeut

Skënderbeu në prozën dhe shtypin amerikan

(Vijon nga faqja 12)

Së bashku, këto dy romane gurmajnë lëvizjen e legjendës së Skanderbeut përmes prozës amerikane dhe shtypit periodik. Ato tregojnë se kjo trashëgimi u formua jo vetëm nga imagjinata autoriale, por edhe nga mekanizmat specifikë të kulturës së shtypit — përkatësisht, serializimi, ilustrimi dhe praktikrat e leximit të një audiencë në zgjerim.

Përmes narrativave të tyre përkatëse, Ludlow dhe Crabb zbulojnë se si heroi shqiptar i shekullit të pesëmbëdhjetë u riktheu dhe u riimagjinua në forma që gëzuan rezonancë përtej kufijve kombëtarë dhe kohorë.

Rikthimi i këtyre teksteve për këtë botim nga Halit Daci u bë i mundur falë arkivave rajonale, shoqatave historike, bazave të gjera të të dhënave të gazetave dixhitale dhe koleksioneve private të librave. Prandaj, sipas autorit Daci, ky volum ofron një mundësi të re për të shqyrtuar se si historia e Skanderbeut u ndërtua, u përhap dhe u riimagjinua në kulturën e shtypit



amerikan.

“Ky botim shërben si një rivendosje e veprave letrare të harruara prej kohësh dhe si një ftesë për rishqyrtimin e përfaqësimit të Skanderbeut brenda kornizës më të gjerë të historisë letrare amerikane”, pohon autori Halit Daci.

ORIGJINALITETI I TEKSTEVE

Skanderbeg në Prozën dhe Shtypin Amerikan riprezinton dy tregime të rralla: historinë e ilustruar të serializuar të James M. Ludlow, *The Captain of the Janizaries*, dhe tekstin e plotë të romanit të vështirë për t'u gjetur të John H. Crabb, *In the Crescent's Dark Shadoë*. Autori Halit Daci, ka meritën e padiskutueshme se pas një punë studimore skrupuloze disavjeçare ka rritur ka arritur t'i paraqesë këto tekste në formën e tyre origjinale, me ndërhyrje redaktuese të kufizuara në korrigjimin e gabimeve të dukshme tipografike dhe të pikësimit për qartësi.



Karakteristikat periodike tipike — duke përfshirë dikcionin karakteristik, praktikrat e ndarjes me vizë, mospërputhjet e brendshme dhe strukturat episodike — janë ruajtur gjatë gjithë tekstit.

Për të ruajtur integritetin historik të veprave, gjuha që mund të duket tashmë arkaike është lënë e pandryshuar — duke përfshirë ruajtjen e përdorimit të ndryshueshëm të Crabb-it të drejtshkrimin britanik dhe amerikan.

Tekstet pasqyrojnë gjuhën, qëndrimet dhe supozimet e periudhës dhe preferencat e të dy shkrimtarëve, dhe ato mund të përmbajnë terma ose përfaqësime që disa lexues bashkëkohorë mund t'i gjejnë ofenduese.

Autori Daci bën të ditur se të gjitha materialet e përfshira në këtë volum janë verifikuar se janë në pronësi publike (public domain) ose janë përdorur nën licencë të përshtatshme në kohën e botimit. Shënime të hollësishme të burimit shoqërojnë tekstet.

RIFORMATIMI I HISTORISË SË ISKENDER BEUTBRENDA KONVENTAVE TË ROMANIT HISTORIK

Në këtë botim të një rëndësie tejet të veçantë, Heroi ynë kombëtar Gjergj Kastrioti (rreth 1405–1468), i njohur gjithashtu si Skanderbeg ose Iskender Beu, qëndron ndër kundërshtarët më të fortë të Perandorisë Osmane në histori. Në hyrje të librit, autori Halit Daci, qëllimisht jep një historik të shkurtër të Gjergj Kastrioti Skënderbeut. “Një fisnik shqiptar i marrë në oborr osman përmes sistemit devshirme në rini, ai u rrit dhe edukua ushtarkisht në shkollat ushtarake osmane, duke u ngritur më në fund në gradën e sanxhakbeut. Në 1443, ai hoqi dorë nga besnikëria osmane dhe e kërkoi përsëri tokën e tyre të paraardhësve.

Nga ajo kohë deri në vdekjen e tij në 1468, Skanderbeg zhvilloi një rezistencë të vazhdueshme dhe shumë efektive kundër forcave osmane shumë superiore. Fitorët e tij i siguruan titullin “Mbrojtës i Kryqit”, dhe emri dhe reputacioni i tij kanë zgjatur për shekuj, duke e siguruar vendin e tij në histori dhe duke frymëzuar një traditë të pasur dhe të vazhdueshme letrare”, shkruan autori i këtij libri. Ndërkohë ai argumenton se megjithëse sulmet ushtarake të Skanderbeut u zhvilluan në të gjithë Shqipërinë dhe Perandorinë Osmane, ruajtja dhe transmetimi i trashëgimisë së tij letrare u formuan kryesisht nga shkrimtarë evropianë — dhe më vonë amerikanë. Kjo për faktin se nga Rilindja e tutje, sulmet e tij frymëzuan historianë, poetë, dramaturgë, novelistë dhe artistë të tjerë.

“Teksti themelor në këtë traditë ishte Historia de vita et gestis Scanderbegi Epirotarum principis e Marin Barleti, e botuar për herë të parë në Romë në fillim të shekullit të gjashtëmbëdhjetë. E përkthyer gjerësisht, kjo biografi tipike siguroi vendin e Skanderbeut në kujtesën kulturore evropiane dhe vendosi kornizën narrative mbi të cilën janë bazuar shumica e autorëve historik dhe letrar”, pohon autori H. Daci. Ai argumenton se tradita evropiane gjeti shprehje të rinovuar



në Amerikë, ku legjenda e Skanderbeut hyri në kulturën letrare amerikane përmes qarkullimit transatlantik të librave, periodikëve dhe arsimit klasik. Ndërsa studiuesit dhe kritikët letrar, sipas tij, kanë vënë në dukje prezantimin e figurës së Skënderbeut në vepra të tilla si— si George Castriot, Surnamed Scanderbeg, King of Albania (1850) e Clement C. Moore, poema “Scanderbeg” (1873) e Henry Ë. Longfelloë, dhe *The Captain of the Janizaries* (1886) e James M. Ludlow — nuk ekziston aktualisht asnjë studim gjithëpërfshirës në lidhje me prezantimin e Skënderbeut në letërsinë amerikane, për ta veçuar atë nga letërsia dhe botimet specifike angleze.

Në të vërtetë, kërkime të mëtejshme zbulojnë se Skanderbeg u shfaq në një gamë të gjerë të produkteve letrare dhe artistike amerikane, duke përfshirë drama, prozë, poezi, ese dhe artet vizuale. Shumë prej këtyre materialeve janë dokumentuar në librin e botuar privatisht nga autori në Amazon, *Skanderbeg* (2022) — botimi me i plote për veprat anglo-amerikane deri më tani — i cili bashkoi si vepra të njohura më parë ashtu edhe vepra të risjella angleze dhe amerikane, së bashku me evidenca të adaptimeve të tjera dramatike të skenizuara në kolegjet katolike në fillim të shekullit të njëzetë.

“Një arritje mjaft e rëndësishme e atij projekti ishte rindërtimi i historisë së dramës më të spikatur të periudhës për këtë temë, *Iskander, Soldier of the Cross* (2022) — performanca dhe pritja kritike e së cilës u dokumentuan dhe ru-

(Viojn në faqen 15)

LIBRI

“DIELLI NË MËRGIM” DHE ANI WILMS NJË DIELL QË PO LIND NË LETËRSINË TONË

Hebrenjtë në Shqipëri, Ani Wilms sjell historinë e rrallë



SHPENDI TOPOLLAJ

Historia e mbrojtjes dhe shpëtimit të hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore nga ana e popullit tonë, atëherë kur kjo ishte një gjë me rrezik të madh është e njohur edhe ndërkombëtarisht. Humanizmi dhe guximi i treguar si nga njerëzit e thjeshtë ashtu dhe nga ana e qeverive që zëvendësonin njëra-tjetrën, me të drejtë na bën të ndihemi krenarë. Por përfytyrimi ynë te këto ngjarje, mbështetur kryesisht në kujtime sporadike apo mirënjohja e vetë dëshmitarëve hebrenj që i përjetuan ato, ka ndalur te strehimi, fshehja, ushqyerja apo pajisja me dokumente false e tyre. Dhe askush nuk është përpjekur të përshkruajë imtësisht, si kohën, ashtu edhe gjendjen emocionale, psikologjinë, mentalitetin, solidaritetin, respektimin e riteve e praktikave zakonore e fetare, vuajtjet, përpjekjet për mbijetesë, dëshirën për punë e kulturë në çdo rrethanë, mbajtjen gjallë të shpresës, zhgënjimet apo dhe ruajtjen e dinjitetit të vetë hebrenjve.

Kështu që tabloja e këtij momenti, nisur qysh kur hebrenjtë, me intuitën e mprehtë nga ndjekjet e përndjekjet e pafundme, i besuan gojëdhënës, se “kushdo që kapërcen kufirin dhe ia del të hyjë në Shqipëri, është i shpëtuar”, – ka qenë disi i cunguar. Dhe ja ku vjen vajza e miqve të mi të hershëm e të respektuar, mjekëve Dezdemona dhe Bashkim Habibi, shkrimtarja Ani WILMS, me romanin e saj voluminoz “Dielli në mërgim”, botim i “Dudaj”, dhe me një talent të rrallë dhe saktësi të mahnitshme e plotëson mjeshtërisht këtë peizazh. Këndvështrimi i kësaj autoreje për strukturimin e këtij romani është krejt i veçantë. Ajo, në njëzet kapituj dhe njëqind e dyzetëdy nënkaptuj i përcjell lëvizjet dhe qëndrimet e personazheve të saj në sfondin e madh dhe shumë të ngarkuar të momentit, pra qysh kurse Shqipëria u pushtua e deri pas vendosjes së të ashtuquajturit pushtet popullor. Në të dy kahjet, ka një intensitet ndodhish, me të papritura, kthesa e befasisira të çuditshme, si dhe përthyerje karakteresh, opinionesh e qëndrimesh të aktorëve të rëndësishëm apo kalimtarë.

HISTORIA E JOSEFIT

Në dukje, gjithçka vërtitet rreth Josef Jakoelit, një njeri paqësor që ndihet sa hebre aq edhe shqiptar. Ai e do shumë familjen e tij, por po aq edhe shqip-

tarët. Beson në ideale dhe vetë është njeri i ndershëm. Bukurinë e jetës e sheh te puna, te shkolla, te muzika, te filozofia, te libri. Ndaj dhe lexon pareshur Shopenhauerin, Balzakun, Çehovin, Haidegerin dhe Frojdin, dhe di ta çmojë miqësinë, si e gjithë familja e tij. Jo më kot Ungj Mateo u drejtohet vlonjatëve të pranishëm me fjalët: “Miqësia juaj peshon për ne më shumë se floriri. Një jetë pa miqësi është gjëja më e trishtë në botë”. Kjo është edhe arsyeja përse zoti Kurti në emër të Këshillit Bashkiak u drejtohet atyre: “Vëllezërit e mi hebrenj! Ky qytet ju admiron për fuqinë dhe durimin tuaj. Ju jeni nga ata që edhe mund të përkulen, por asnjëherë nuk thyhen”. Hebrenjtë kudo që i përplasi fati, nuk ndenjën duarkryq. Ata e gjenin mundësinë që me djersën e ballit ta përballonin jetesën e tyre. Edhe familja e Josef, qysh nga babai i tij Rafaeli, kishin ngritur tregtinë e manifakturës me emrin “Levi & Jakoe” si në Vlorë, ashtu dhe në Durrës. Josefi punonte, por edhe mezi i priste takimet me intelektualë, dhe lumturohej me bisedat me doktorin Quandt, të cilin e quante mentorin e tij. Formimi i tij e kishte shpënë në përfundimin se “Kultura është diçka që i jep një ndjesi pavdekësie atij njeriu që e kupton. Sepse ajo krijon një lidhje mes realitetit shqisor dhe të mbinatyrshmes”. Por ja që shpesh realiteti i egër e bën krejt të pafuqishëm si perceptimin, ashtu edhe vetë qëndrimin ndaj tij. Se po të ishte për mbivlerësimin dhe fetishizimin e kulturës dhe ndikimin e saj në jetën e përditshme nuk kishte pse populli gjerman, me shpikjen e tij, ideologjinë naziste, t’i shkaktonte aq e aq dhimbje e vuajtje të papërshkrueshme një populli tjetër, po ashtu mjaft të kulturuar, siç ishin hebrenjtë, të cilin i shkaktoi jo pak, por plot gjashtë milion viktima. Natyra njerëzore është e çuditshme; edhe doktori nuk e shpjegon përse edhe “shqiptari nuk e kupton dot, madje i vjen keq, se përse këto dy kombësi të admirueshme, gjermanët dhe hebrenjtë, të jenë të armiqësuar me njëri – tjetrin”. Nga kjo, mesa duket Josefi sheh ëndrra me ulërima tmerri dhe kur e pyet doktorin, ai i përgjigjet si psikolog që është se “...lufta vjen nga brenda... Orteku i maktheve dhe tmerreve merr përpara trutë e njerëzisë dhe i varros nën vete.

BASHKËSIA HEBREJE

Njerëzit rezistojnë për një fare kohe, por pastaj dorëzohen dhe tmerri u pushton shpirtrat. Ky është burimi i gjithë luftërave: dhimbjet e ngërçet e padurueshme që shtojnë njerëzit deri në pragun e çmendurisë. Kjo është arsyeja që ata ngrihen e bëjnë pastaj gjëra që në kushte normale s’do i bënin kurrë. Vdekja në këtë rast shërben si rrugëdalje, si shpëtim, si kapak floriri”. Dhe ai përfundon se “...tërbimi dhe dhimbja rriten derisa e mundin arsyen. Deri sa vjen çasti që njeriu e harron se ç’është arsyeja”. Dhe kur Rafaeli mbron mendimin se duhet ndihmuar Lëvizja Nacional – Çlirimtare që lufton pushtuesin, i pavenosuri Mateo, sjell fjalën e urtë se “erën nuk e kthen dot, por velat po”. E vërteta është se në këto situata bashkësia hebreje është e çoroditur. Ata mblidhen e diskutojnë rregullisht për qëndrimet që duhet të mbajnë dhe përgjithësisht janë për ta mbështetur me gjithçka mundin rezistencën e djemve dhe vajzave që kanë dalë malit. Edhe vetë Josefi bashkohet me ta dhe shërben te ai manastiri ku drejton prifti patriot që e thërrisnin Papa Theodhosi. E sheh nga afër guximin e sakrificat e partizanëve dhe partizaneve, ku ishin përfshirë edhe ato bukuroshet delikate të kursit të baletit që dikur e drejtonte Miriami. Ama,

kjo nuk do të thotë se edhe midis vetë shqiptarëve, nuk ndikon kjo çoroditje; ata me bindjen se po luftojnë armikun e jashtëm, ndahen në komunistë, ballistë dhe legalistë. Pastaj, lufta për parësi e pushtet i hedh kundër njëri – tjetrit. Ky është dhe momenti më i vështirë për ta trajtuar, për autoren e këtij romani. Por Ani WILMS, me një zgjuarsiri dhe paanësi të pandeshur më parë, as historikisht dhe as artistikisht, nuk gabon askund në zgjidhjen e këtij rebusi, të nisur qysh nga e famshmja Marrëveshje e Mukjes, që na ka zënë për fyti e s’po na lëshon, prej tetëdhjetëepesë vitesh. Ja, Zaho Panari, me partizanët, piktori Lazar, me nacionalistët, e mira Aulona që aq shumë e dashuronte në heshtje Zahua, e cila vetëm përhap libra e kulturë te Librari Gega, kjo vajzë e një atdhetari të shquar, ankohet se po e shohin si armike, dhe ndëshkohet nga gjyqet e analfabetëve se donte të konkurronte në zgjedhje me një parti të re, Kaninët janë stepur, miqtë e Kavajës, familja e Shyqyri Myrtos, që e kishin mbajtur si birin e tyre Josefin e kishin pësuar, dhe Kurti përfundon keq, për nipin, Adrianin. Kjo situatë që solli këtë përçarje, natyrisht që lë mbresa të mëdha te Josefi, dhe trondit bindjet e tij. Dhe kur sheh se ligjet e reja që në nxitim e sipër, përpiluan fitimtarët, e prekën edhe familjen e tij, pa as më të voglin faj, por dhe pa asnjë mëshirë e mirënjohje, për më tepër që edhe i kishin ndihmuar ata, pashmangësisht vjen zhgënjimi.

BURGOSJA E PASANIKËVE

Burgosje të pasanikëve hebrenj, konfiskim pasurie, taksa mbi fitimin e jashtëzakonshëm gjatë luftës, dorëzim deri me tortura të floninjve, kishin dalë në rend të ditës, ashtu siç kishte parë plot intelektualë e nacionalistë të pushkatuar rrugëve nga vëllezërit e një gjaku. Jakoelëve, si shumë të tjerëve, pasi iu shkatërrua biznesi, iu morën edhe shtëpitë. Familjes së Josef, përveç babait dhe të afërmeve që ia burgosën, i morën gjithë ç’kishin dhe i degdisën në mjerimin e një kasolleje. Tani, askush nuk i ndihmonte dot, qofshin ata dhe nga miqtë e dikurshëm. Njerëzit ishin tjetërsuar dhe spiunët gëlonin ngado.

I trembur ishte dhe vetë Zaho që pasi ishte plagosur rëndë atje në mal, tani kishte një farë funksioni, ai Zaho që dikur e konsideronte vëlla dhe i quanin si vëllezërit Dioskurë, Kastori dhe Polluksi. Mesa dukej edhe në jetën e vërtetë, me ta po ngjiste njësoj si në mitologji, ku pasi Kastori u vra nga Linkeu dhe ky nga Polluksi, duke qenë se njëri ishte i vdekshëm dhe tjetri jo, Zeusi iu përgjigj lutjes, duke i vendosur në mes të yjeve, me emrin Binjakët, por kur njëri shfaqej, tjetri fshihej, pra nuk shiheshin kurrë. Josefi habitet sesi ndryshuan gjërat dhe njerëzit kështu. Ai ishte rritur mes murgjve në Janinë dhe dikur komunizmi ia kishte ngrohur zemrën, por kishte filluar të ftohej me të kur shihte se shokët atje në Moskë u kërkonin të rinjve të gënjenin dhe të vidhnin etërit e tre për të financuar lëvizjen. Dhe paskej pasur të drejtë: Si ishte e mundur që ata vlonjatët e mirë e mikpritës, tani rrinin pas dyerve të gjyqeve, dhe duke dëgjuar ato broçkullat që dilnin nga alto-parlantët, ulërinin “Armiqtë, në litar!”.

“MBRETI I MIRË”

Në libër thuhet: “Vlora e mençur ishte zhdukur nga faqja e dheut, kishte mbetur vetëm ajo e marra”. Paskej pasur të drejtë Aulona e Gegajve kur

(Vijon në faqen 15)


LIBRI

“DIELLI NË MËRGIM” DHE ANI WILMS NJË DIELL QË PO LIND NË LETËRSINË TONË

Hebrenjtë në Shqipëri, Ani Wilms sjell historinë e rrallë

(Vijon nga faqja 14)

i thoshte atij se: “Kush djallin është Enver Hoxha? E dëgjove atë fjalim që mbajti? Si lehje qeni, më keq se Musolini. Një dështak universitar, një injorant province me delir madhështie, ja kush është”. Ishte lodhur kot Aristoteli të gjente mbretin e mirë, pavarësisht emrit; perandor, president, Duçe, Fyhrer apo sekretar i parë. Po shkallmohej gjithçka ishte ngritur me aq mund, me arsytimin se do të ndërtonin botën e re. U pa se tipari kyç i revolucionit qenka deliri i shkatërrimit. Gjithçka po shkonte drejt Jugosllavisë e Stalinit, se tani ata po e bënin ligjin dhe nuk qenë të pakët të tjerët që shpresonin të ndërhyrja e Perëndimit e kryesisht e Britanikëve. Por, aha... Nga ana e tyre, familja e Josefit, edhe atje në ftohtësinë e kasolles me mure me vrima, respektonte ritualet e hebrenjve dhe lumturohej se pasi kishin ndrequr radion, do dëgjonin me zë të ulët muzikën e drejtorit të teatrit Skala, Arturo Toskaninit (1867 – 1957), me zërin e Tancredi Paseros dhe Renata Tebaldit. Dhe përfundimi: Josef Jakoeli, të cilit tani shokët dhe miqtë i largoheshin, me keqardhje shpreh bindjen se “Shqipëria është bërë një burg i madh nën qiell të hapur”. Dhe i vetmi ngushëllim në këtë valle të madhe të popujve, siç e quante doktori, mbetej ta pranonte katastrofën si çast historik, në vend që ta linte veten të dërmohej shpirtërisht prej saj. Nuk mund të rri pa përmendur faktin se Ani WILMS, ia shton vlerat librit dhe e bën tërësisht të tërheqës, të këndshëm dhe të besueshëm atë, duke na i dhënë me imtësinë më të madhe dhe



duke na i përshkruar sikur të ishte vetë hebrenje, festat e tyre apo ditët e shënuara që ata praktikonin. Pa asnjë mëdyshje, mendoj se ky roman i bën nder letërsisë tonë dhe do të zërë pa tjetër



një vend të rëndësishëm në gjerdanin e artë të romanit shqiptar. Gjithashtu, na paralajmëron se një prozatore me të ardhme të ndritur po duket andej nga Dielli lind!

Skënderbeu në prozën dhe shtypin amerikan

(Vijon nga faqja 13)

ajtur gjerësisht në shtypin periodik të kohës — duke kulmuar në një studim të rrallë arkivor, gjithashtu të panjohura për lexuesit. Me këtë bazë të vendosur, ky volumen i kthehet dy tregimeve të harruara fantastike amerikane që dikur hynë — dhe më vonë u zbehën nga — vetëdija letrare amerikane, duke gjurmuar se si legjenda dhe trashëgimia e Skanderbeut u përfaqësuan në prozë dhe u përhapën përmes shtypit periodik në Shtetet e Bashkuara”, shkruan autori i këtij libri. Ai bën të ditur për lexuesin se e para, The Captain of the Janizaries e Ludlow, transkriptohet nga serializimi i saj i gazetave të 1905-ës, një adaptim i mëvonshëm dhe i dallueshëm i botimit të njohur të librit të 1886-ës.


I përmirësuar nga ilustrime të rralla, ky version i lejoi lexuesve të përballëshin me narrativën vizualisht dhe në mënyrë episodike. Rikthimi i tij nxjerr në pah rolin qendror të shtypit periodik në formimin e angazhimit letrar amerikan me Skanderbeun.

Vepra e dytë, In the Crescent's Dark Shadoë e John H. Crabb, e riformatit historinë e Iskender Beut brenda konventave të romanit historik. Ajo thekson çështjet e formimit të identitetit dhe zgjimit kombëtar në Shqipërinë e shekullit të pesëmbëdhjetë, ndërsa detajon me kujdes pozicionin gjeopolitik të Shqipërisë midis Perandorisë Veneciane dhe Osmane.

Pavarësisht meritave mjaft të çmuara për prezantimin e figurës së Skënderbeut, romani

është harruar plotësisht, është i panjohur dhe mbijeton sot vetëm në kopje të rralla, vetëm në tre biblioteka, dhe është e vështirë për t'u gjetur në shitje. Si pasojë, si Crabb ashtu edhe vepra e tij kanë mbetur marginale në studimet për Skanderbeun dhe kryesisht të panjohura për lexuesit bashkëkohor.

Së bashku, këto romane tregojnë përshatshmërinë e vazhdueshme dhe të qëndrueshme të legjendës së Skanderbeut në letërsinë amerikane. Ato ilustrjnë se si pena autoriale nga periudha dhe profesione të ndryshme e përshatën legjendën e Skënderbeut në periudha të ndryshme. Duke i vendosur këto vepra brenda konteksteve të tyre specifike historike dhe studimeve më të gjera mbi Skanderbeun në Amerikë, kjo botim kritik ofron një kuptim të ri se si një figurë e vetme legjendare bëri të mundur të lidh shekuj, kontinente, dhe median.



MOZAIK

Këshilli Bashkiak vlerëson gruan e parë shqiptare që mban gradën madhore në FA të RSH

GJENERALMAJOR MANUSHAQE SHEHU “QYTETARE NDERI” E DIBRËS

- Me vendimin nr. 82, datë 03.11.2025, Këshilli Bashkiak Dibër ka vlerësuar kontributin e saj të jashtëzakonshëm në mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare, promovimin e vlerave kombëtare, të figurës së gruas shqiptare në strukturat më të larta të shtetit dhe për shembullin frymëzues që ajo përçon për brezat e rinj*



NDERIMI

KOLONEL TRIFON LLUPO “NDERI DHE KRENARIA” E OBVLP

- KRYESIA E OBVLP I UROI DITËLINDJEN N/KRYETARIT TË OBVLP TRIFON LLUPO, I CILI MBAN MBI SUPE TREÇEREK SHEKULLI (75 VJET) KARRIERË USHTARAKE E CIVILE SHEMBULLORE*

